


Pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut

Studimi 2023



Pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut

Studimi 2023

Projekti: Praktiko demokraci

Titulli i origjinalit: Социо-политичко учество на младите во Северна Македонија
E përkthyer nga maqedonisht në shqip

Botues: Fondacionit Westminster për Demokraci, Maqedonia e Veriut
www.wfd.org

Për botuesin: Dona Kosturanova, drejtore në vend për zyrën
e Fondacionit Westminster për Demokraci

Autor i analizës: Martin Galevski

Realizimi i anketës: TIM institut

Redaktore: Ina Xhugumanova

E përkthyer nga maqedonisht në shqip: Jetmir Ziba

Rregullimi grafik: Koma

Tirazh: 50

Shtypshkronja: Data Pons

Vendi i botimit: Shkup

Data e botimit: 2024

Kjo analizë u përgatit në kuadër të projektit "Praktiko demokraci" i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë gjithmonë mendimet dhe qëndrimet të Qeverisë Britanike.

Përmbajtja

006

Parathënie

010

Gjetjet kryesore

016

Hyrje:
Pasqyra e
situatave aktuale
me të rinjtë në
vitin 2022 dhe
2023

028

Metodologjia
dhe mostra

036

Gjetjet e anketës
në terren i mostrës
përfaqësuese:
Pjesëmarrja
socio-politike e të
rinjve në Maqedoninë
e Veriut

037

Perceptimet e të rinjve
për rrjetet sociale në vend
dhe pozita e të rinjve në
shoqëri

047

Qëndrimet e
të rinjve mbi
perspektivën
evropiane të
vendit dhe
përfitimet nga
anëtarësimi në
NATO

059

Migrimi dhe planet për
të ardhmen të të rinjtë

068

Burimet e informimit dhe
interesi në zhvillimin
sociopolitik të të rinjve

076

Besimi tek institucionet
dhe ndikimi personal

085

Pjesëmarrja qytetare
e të rinjve në shoqër

98

Votimi në zgjedhje dhe
motivimi për të votuar

101

Arsimi si element i
socializimit politik:
Përputhshmëria me
përmbajtjet e teksteve
shkollore

106

Toleranca dhe perceptimet
për grupet tjera

112

Shkalla e pajtueshmërisë
me deklaratat që lidhen me
veprimtarinë socio-politike,
vlerat politike dhe mendimin
kritik

118

Perceptimet dhe
qëndrimet e të rinjve
me aftësi të kufizuara
senzorike dhe/ose
dhe/ose motorike për
situatën në vend

122

Gjetjet e përmbledhura
nga grupet e fokusit

128

Diskutim dhe
përfundime

134

Rekomandime



PARATHËNIE

Ky studim i katërt mbi pjesëmarrjen socio-politike të të rinjve në Maqedoninë e Veriut ofron informacione më të thelluara deri më tani nga të gjitha studimet e mëparshme të Fondacionit për demokraci të Uestminsterit (WFD) në fushën e pjesëmarrjes socio-politike të të rinjve. Studimi i parë, i krijuar në vitin 2019, rezultoi informues dhe i përdorur nga shumë aktorë të përkushtuar ndaj të rinjve, duke filluar nga organizatat rinore dhe vetë aktivistët, deri te mediat dhe institucionet. Me çdo studim të mëvonshëm, ne u përpoqëm të hapnim tema të reja ose të hynim më thellë në fushat që u dëshmuan të ishin të rëndësishme. Ky studim i katërt ofron pasqyrën më të thelluar të të dhënave për një numër arsyesh. Së pari, falë realizimit në terren, arritëm të integrojmë më shumë çështje në disa fusha, siç është Bashkimi Evropian, vlerat demokratike dhe toleranca. Përveç kësaj, me këtë hulumtim, tashmë mund të shohim tendenca afatgjata të të rinjtë, në katër intervale, nga viti 2019 deri në vitin 2023. Për ne është e rëndësishme që përfshihen përsëri të rinjtë me aftësi të kufizuara, si një kategori qytetarësh që shpesh për fat të keq lihen jashtë hulumtimeve të tilla.

Analiza jep gjithashtu një pasqyrë të rrethanave dhe ndryshimeve socio-politike. Kështu, për një ndryshim, kemi të dhënat nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2021 që na ballafaqojnë me tendencat negative të plakjes së popullsisë dhe largimit, si dhe projeksionet që na paralajmërojnë për të ardhmen që vijon. Pasojat e krizës me KOVID-19 dhe krizës ekonomike kanë lënë gjurmë në arsimin dhe mësimin, punësimin dhe standardin e të rinjve. Megjithatë është arritur miratimi i një Strategjie të re nacionale për të rinjtë 2023-2027, megjithatë është e dukshme mungesa e mjeteve për zbatimin e saj, si dhe për politikën rinore dhe arsimin në përgjithësi. Pas më shumë vitesh, filloi me reflektimin mbi zbatimin e Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore dhe zbatimin jo të plotë të tij, por dalin edhe rekomandime për avancimin e ligjit. Shëndeti mendor i të rinjve, si një temë e re, po merr gjithnjë e më shumë vëmendje dhe aktualizim, dhe gjithashtu theksohet miratimi i strategjisë së parë shtetërore kushtuar shëndetit mendor të të rinjve. Megjithatë, megjithëse ka ndryshime në aspekte të caktuara, shumë nga rekomandimet e shprehura në studimet e mëparshme ende vlejné, respektivisht gjendjet nuk kanë ndryshuar ndjeshëm.

Me këtë analizë, ne arritëm të sigurojmë të dhëna, të cilat shpresojmë të përdoren nga institucionet, të rinjtë dhe palët e tjera të përfshira në krijimin e politikave të bazuara në dëshmi. Të dhënat na tregojnë se cilat janë perspektivat e të rinjve për BE dhe NATO, tendencat dhe pritjet e ardhshme për përparimin e shtetit, perceptimet për largimin, perceptimet për pjesëmarrjen e tyre, besimin në institucione, vlerat demokratike dhe tolerancën – tema të rëndësishme jo vetëm për gjeneratat e reja, por edhe për të gjithë shoqërinë.

Gjetjet janë paraqitur në detaje në studim, por në këtë hyrje të shkurtër, me qëllimin për të dhënë një perspektivë optimizmi, do të veçoja disa nga

perceptimet kryesore pozitive. Të rinjtë nuk mendojnë se politika është punë vetëm e politikanëve, as se votimi në zgjedhje është i mjaftueshëm për të ndikuar. Megjithatë, ata kanë nevojë për besim, informacione, njohuri dhe mbështetje për të qenë qytetarë aktivë, sepse shumica e të rinjve nuk janë aktivë. Të rinjtë që kanë ndërmarrë veprime për ndryshim janë më të prirur të veprojnë përsëri dhe të shprehin kënaqësi më të madhe me vendin e tyre në shoqëri. Të rinjtë që presin që shteti të jetë pjesë e BE-së janë edhe ata me tendenca më të ulëta për largim. Pak më pak se gjysma e të rinjve, megjithatë, mendojnë se ka potencial për ndryshime pozitive në vend. Shembuj të tillë pozitivë duhet të mbështeten, ndërsa duhet të punohet në mënyrë të barabartë për të gjetur dhe adresuar shkaqet e tendencave negative.

Shprehim mirënjohjen tonë për Martin Galevskin për përgatitjen e kësaj analize, si dhe TIM institut për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për Qeverinë Britanike dhe Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut në Shkup, mbështetja e së cilës ishte thelbësore për përgatitjen e studimit.

Dona Kosturanova,
Drejtoreshë në vend për
Fondacionin për demokraci të Uestminsterit



GJETJET
KRYESORE

Rritet pesimizmi te të rinjtë për rrjedhat sociale në shtet

- Më pak se një në pesë të rinj (17%) mendojnë se Maqedonia e Veriut po lëviz në drejtimin e duhur. Që nga hulumtimi i parë i kryer në vitin 2019, numri i të rinjve që mendojnë se vendi po lëviz në drejtim të gabuar është dyfishuar, nga 24% në 50%.
- Vetëm një e katërta e të rinjve mendojnë se në pesë vjet nga sot, vendi ynë do të jetë një vend shumë ose pjesërisht më i mirë për të jetuar për të rinjtë. Që nga hulumtimi i parë në vitin 2019, numri i të rinjve që mendojnë se në pesë vjet vendi do të jetë një vend shumë ose pjesërisht më i keq për të jetuar është rritur me 26% (nga 18% në 42%).
- Vetëm një në tre të rinj (32%) është i kënaqur me vendin e tij në shoqëri.
- Ana pozitive është se 4 nga 10 të rinj besojnë se vendi ka potencial për ndryshime pozitive.

Po bien edhe shpresat për të hyrë BE

- Për herë të parë nga realizimi i hulumtimit, një përqindje më e lartë e të rinjve (43%) thanë se nuk besonin se vendi do të bëhej pjesë e Bashkimit Evropian, krahasuar me ata që mendonin se do të bëhej (38%). Rreth një e pesta e të rinjve (19,4%) nuk e dinë nëse vendi do të bëhet anëtar. Krahasuar me vitin 2019, ka një rënie të optimizmit për mundësinë e anëtarësimit me 22%.
- Sipas përkatësisë etnike, përqindja e maqedonasve etnikë që besojnë se vendi nuk do të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian është dukshëm më e lartë se midis shqiptarëve etnikë dhe grupeve të tjera etnike. Respektivisht, pothuajse gjysma e të rinjve maqedonas (47,8%) besojnë se shteti nuk do të bëhet një shtet anëtar i BE-së, kundrejt 30,6% të të rinjve shqiptarë dhe të rinjve nga grupe të tjera etnike (42,1%).
- Midis të rinjve që shprehin bindjen se vendi do të bëhet anëtar i BE-së, pritshmëria mesatare është që kjo të ndodhë deri në vitin 2032, respektivisht 9 vjet nga sot.¹ Në vitin 2019, kur hulumtimi u krye për herë të parë, mesatarisht, të rinjtë besonin se vendi do të hynte në BE për 6 vjet nga data e hulumtimit (muaj maj 2019).
- Të rinjtë besojnë se anëtarësimi në BE varet kryesisht nga shtetet anëtare të BE-së dhe gatishmëria e tyre për zgjerim (50,2%), por me një përqindje të ngjashme nga institucionet shtetërore dhe përmbushja

1 Si pikë fillestare merret viti në të cilin është kryer hulumtimi, viti 2023.

e kriterëve të anëtarësimit (48%). Zgjidhja e kontestit me Bullgarinë shihet si pengesë nga 44,8% e të rinjve, ndërsa ndikimi i faktorëve të tjerë jashtë vendit dhe BE-së është një faktor i rëndësishëm për 29,2% të të rinjve.

- Një e treta e të rinjve (33%) mendojnë se jemi më larg anëtarësimit në BE në krahasim me këtë periudhë të vitit të kaluar. Vetëm 17% e të rinjve mendojnë se jemi më afër anëtarësimit në BE, ndërsa 44% nuk shohin ndryshime në perspektivat e vitit të kaluar.
- Ana pozitive është se të rinjtë që besojnë se vendi një ditë do të bëhet një shtet anëtar i BE-së tregojnë gatishmëri më të ulët për t'u larguar nga shteti. Më saktësisht, nga ata të rinj që mendojnë se vendi do të bëhet anëtar i BE-së, 46,8% po mendojnë të shpërngulen, ndërsa e njëjta vlen për 76% të të rinjve që mendojnë se vendi nuk do të bëhet anëtar i BE-së.

Të rinjtë kanë mendime të ndara për përfitimet e anëtarësimit në NATO

- 47,3% e të rinjve mendojnë se ka përfitime nga anëtarësimi në NATO, ndërsa 45,5% besojnë se nuk ekzistojnë përfitime nga anëtarësimi.
- Për sa i përket mënyrës se si anëtarësimi në NATO ndikon në siguri, një e treta e të rinjve (34,5%) ndihen më të sigurt, 8,9% ndihen më pak të sigurt dhe në pak më shumë se gjysmën e të rinjve (53,9%) anëtarësimi në NATO nuk ka ndikim në ndjenjën e tyre të sigurisë.
- Ndarja kryesore në përgjigje është midis të anketuarve të përkatësive të ndryshme etnike. Në fakt, 60,8% e shqiptarëve etnikë ndihen më të sigurt për shkak të anëtarësimit në NATO, ndërsa kjo është e vërtetë vetëm për 24,7% të maqedonasve etnikë dhe 37,4% të të anketuarve nga grupet e tjera etnike.

Pjesa e të rinjve që janë të gatshëm të migrojnë mbetet e lartë, ndërsa numri i atyre që potencialisht do të kthehen është në rënie

- Gjashtë nga dhjetë të rinj (62%) do të largoheshin nga vendi nëse do t'u jepej mundësia. Megjithatë ka pasur pak rritje, nuk janë vërejtur ndryshime të rëndësishme që nga hulumtimi i parë në vitin 2019 (59,5%).
- 77% e të rinjve nuk e mendojnë kthimin në vend nëse migrojnë. Kjo është një rritje prej 14% krahasuar me hulumtimin e mëparshëm në vitin 2021.

Të rinjtë nuk e shohin veten si prioritet të institucioneve dhe nuk kanë besim të lartë në asnjë institucion

- Gjysma e të rinjve (51,4%) mendojnë se institucionet nuk kujdesen aspak për nevojat dhe problemin e tyre, dhe vetëm 1,1% mendojnë se institucionet kujdesen plotësisht për nevojat dhe problemet e tyre.
- Tre të katërtat e të rinjve (73,7%) deri më tani nuk janë përfshirë ose konsultuar nga institucionet lokale ose nacionale gjatë marrjes së vendimeve.
- Asnjë institucion/organizatë nuk gëzon besim të moderuar ose të lartë të të rinjve (respektivisht, asnjë nga institucionet/organizatat e rradhitura nuk arriti të marrë një rezultat më të lartë prej 2.5, në një shkallë nga 1 deri në 5). Më vlerësim më të ulët nga të rinjtë janë Parlamenti (nota mesatare 1,8), partitë politike (nota mesatare 1,9) dhe Qeveria (nota mesatare 1,9).

Shumica e të rinjve nuk janë aktivë në shoqëri

- 8 nga 10 të rinj e përshkruajnë veten si qytetarë kryesisht ose aspak joaktivë kundrejt një të katërtës së të anketuarve që kryesisht e identifikojnë veten si aktivë në shoqëri (rënie e qytetarëve aktivë me 6% krahasuar me vitin 2021). Deri në 3 nga 4 të rinj (74,4%) nuk i përkasin asnjë organizate ose forme tjetër të organizimit (rritje prej 6% në krahasim me vitin 2019). Nga ata të rinj që janë aktivë në një formë të organizimit (25,6% e të rinjve), ata më së shpeshti e bëjnë këtë në kuadër të partive politike/forumeve rinore politike (9,9%), dhe pothuajse dy herë më pak në organizatat qytetare ose rinore (5%) dhe iniciativat qytetare joformale (4,0%).
- Te të rinjtë që bëjnë diçka për të zgjidhur një problem të veçantë shoqëror, shumë pak arrijnë të zgjidhin problemet (28,6%), ndërsa të rinjtë e tjerë rrallë (52,4%) ose kurrë (17,5%) nuk kanë sukses në përpjekjet e tyre.


Numri i personave të rinj që votojnë në zgjedhje mbetet i lartë

- Nëntë nga dhjetë të rinj në vend gjithmonë ose ndonjëherë votojnë në zgjedhje, nga të cilat 59% gjithmonë votojnë (5% më pak se në vitin 2019), ndërsa 31% ndonjëherë votojnë.
- Ana pozitive është se pjesa më e madhe e të rinjve (78%) nuk mendojnë se politika është çështje vetëm e politikanëve dhe 73,2% e të rinjve nuk mendojnë se për të ndikuar në politikë mjafton vetëm votimi në zgjedhje. Gjithashtu, 72,4% e të rinjve nuk pajtohen me deklaratën

se është më mirë të mbajnë për vete mendimin e tyre për zhvillimet politike sesa ta thonë atë publikisht.

Të rinjtë bëhen gjithnjë e më pak tolerant dhe gjithnjë e më autoritar

- 81% e të rinjve besojnë se vendi ka nevojë për një lider me dorë të fortë (ngjashëm me hulumtimin e vitit 2021).
- 54% e të rinjve besojnë se personat LGBT nuk kanë vend në politikë (rritje prej 19% që nga viti 2021).
- 29% e të rinjve mendojnë se burrat janë politikanë më të mirë se gratë (një rritje prej 13% që nga viti 2021).
- 43% e të rinjve nuk do të donin të kishin një fqinj LGBT, 36% një fqinj emigrant, 25% një fqinj rom dhe 24% një fqinj shqiptar.



HYRJE:
PASQYRA E
SITUATAVE
AKTUALE ME TË
RINJTË NË VITIN
2022 DHE 2023

Kjo hyrje synon të ofrojë një pasqyrë të situatës aktuale me të rinjtë gjatë dy viteve të fundit (2022 dhe 2023),² duke u qasur kryesisht në hulumtimet e kryera për të rinjtë dhe dokumentet strategjike për të rinjtë që janë përgatitur në të njëjtën periudhë.

Midis dy regjistrimeve të popullsisë, mijëra të rinj janë larguar nga shteti. Vendi po humbet kapitalin njerëzor.

Numri i të rinjve në Maqedoninë e Veriut është në rënie që nga viti 2002. Midis dy regjistrimeve të popullsisë nga viti 2002 deri në vitin 2021, analizat tregojnë se numri i të rinjve u ul me 6%, nga 24% në vitin 2002 në 18% në vitin 2021.³ Kjo do të thotë se shteti ka afërsisht 80.000 të rinj më pak në krahasim me vitin 2002. Përkundër një rënieje të tillë, përqindja e të rinjve në numrin e përgjithshëm të popullsisë është ende më e lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian (16%) siç janë shumica e vendeve në rajon me përjashtim të Malit të Zi (19%), Shqipërisë (23%) dhe Kosovës (25%).

Për sa i përket grupmoshave, sipas regjistrimit të fundit të vitit 2021, grupmosha më e re është 15-19 vjeç, dhe më së shumti në grupmoshën 25-29 vjeç, ndërsa më së paku të rinjtë jetojnë në rajonin e Vardarit, dhe më së shumti në rajonin e Shkupit. Në nivel lokal, të gjitha komunat në vend (përveç njëjës, Likova) shënojnë rënie të përqindjes së të rinjve, pjesërisht për shkak të migrimit të brendshëm dhe pjesërisht për shkak të migrimit të jashtëm.

Analiza të tilla konfirmojnë projeksionet e bëra para regjistrimit të popullsisë, të cilat vazhdimisht theksojnë se vendi po përballet me një problem serioz në lidhje me emigrimin e të rinjve dhe mbajtjen e popullatës së re në vend, si dhe plakjen e përshpejtuar të popullsisë. Numri më i madh i të rinjve që nuk janë tashmë banorë të Maqedonisë së Veriut janë të rinj të lindur në vitin 1994, domethënë ata që ishin 27 vjeç në vitin 2021. Në fakt, 30% e të rinjve të asaj gjenerate nuk jetojnë më në shtet. Përqindja më e ulët e largimit është te të rinjtë e lindur në vitin 2003 (ata ishin 18 vjeç në vitin 2021), vetëm 8% e tyre u larguan nga shteti.⁴

2 Tre hulumtimet e mëparshme të WFD të realizuara në vitet 2019, 2020 dhe 2021 përpunuan tema të ngjashme dhe fenomene të mëparshme, prandaj në kuadër të këtij hulumtimi periudha kohore për analizë është kryesisht e kufizuar në vitin 2022 dhe 2023 (duke përfshirë muajin dhjetor)

3 Malevski, B. dhe Barakovski, P. (2023). Të rinjtë në regjistrim të popullsisë: Analiza e të dhënave të regjistrimit të popullsisë, ekonomitë familjare dhe banesat nga viti 2021 që kanë të bëjnë me të rinjtë. Shkup: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit.

4 Ibid.

Në bazë të regjistrimit e vitit 2021, Enti shtetëror i statistikave përgatiti shtatë projeksione të popullsisë në Maqedoninë e Veriut deri në vitin 2070.⁵ Variantet janë nën supozimin se nuk do të ketë luftëra në vend dhe rajon, do të ketë një situatë të brendshme politike normale dhe të qëndrueshme, në gjysmën e parë të viteve 2030 do të përfundojë procesi i asociimit në BE, do të ketë zhvillim ekonomik dhe nuk do të ketë kriza të mëdha shëndetësore. Vëzhguar sipas varianteve të projeksionit, nëse asgjë nuk ndryshon dhe parametrat mbeten nga viti 2022, popullsia e përgjithshme deri në vitin 2070 mund të ulet me 35%, respektivisht, nga 1,8 milion banorë aktual në 1,2 milion banorë. Në të njëjtën kohë, realizimi i varianteve në të cilat supozohet vonesa e migrameve të jashtme, me një rritje të moderuar të nivelit të fertilitetit, si dhe një rënie të vazhdueshme dhe relativisht intensive të vdekshmërisë, do të rezultonte në një rënie të popullsisë me “vetëm” 346 mijë persona ose me një të pestën (19%) krahasuar me fillimin e periudhës së projeksionit. Mbi shkallën e shpopullimit të mundshëm, të cilit i referohen rezultatet e parashikimeve, ndikojnë edhe krahasimet e popullsisë së parashikuar në vitin 2070 me të dhënat nga regjistrimet e mëparshme të popullsisë. Është shumë ilustruese që në fund të periudhës së projeksionit, popullsia në vend, në rast të realizimit të ndonjë prej varianteve të projeksioneve, do të ishte më pak e madhe se ajo 100 vjet më parë, respektivisht në kohën e regjistrimit të popullsisë të vitit 1971.

Sa i përket grupmoshave, realizimi i variantit të fertilitetit të lartë, në vitin 2070, do të rezultonte në dyfishin e numrit të të rinjve (të moshës 0 deri në 14 vjeç) sesa në rastin e variantit të fertilitetit të ulët (244,4 mijë deri në 114,7 mijë) dhe do të theksonte pjesëmarrje më të madhe në popullatën e përgjithshme (17,2% ndaj 10,3%). Arritja e ndonjë prej gjashtë varianteve të mbetura të projeksionit në fund të periudhës së projeksionit do të rezultonte në një numër edhe më të vogël të të rinjve (të moshës 0-14 vjeç), si dhe pjesëmarrjen e tyre më të ulët në popullsinë e përgjithshme të vendit. Rënia më e madhe e numrit të të rinjve do të ndodhte në rastin e realizimit të variantit konstant (nga 309 në 48 mijë), ndërsa pjesëmarrja e tyre më e vogël do të ndodhte në rastin e arritjes së variantit me fertilitet të ulët (10,3%). Të gjithë treguesit e përmendur tregojnë se Republika e Maqedonisë së Veriut po përballlet me një periudhë plakjeje shumë intensive të popullsisë, jo vetëm në krye të piramidës së moshës, por edhe nga baza e saj. Megjithatë, plakja demografike për shkak të pjesëmarrjes së zvogëluar të të rinjve do të ishte më pak e rëndësishme për vetë procesin.

5 Enti shtetëror i statistikës. (2023). Projeksionet e popullsisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2070. Shkup: Enti shtetëror i statistikës.

Duke marrë parasysh këto sfida, projekt-versioni i Strategjisë për politikat demografike të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2024-2044 është në proces të përgatitjes. Ky është dokumenti i tretë i këtij lloji në Maqedoninë e Veriut. Vizioni i Strategjisë është të ndikojë në ruajtjen e nivelit aktual të popullsisë në periudhën deri në vitin 2044, të rrisë ndjeshëm potencialin e kapitalit njerëzor dhe të sigurojë një cilësi më të mirë të jetës për të gjitha gjeneratat, së bashku me përmirësimin e zhvendosjes territoriale të popullsisë. Për të arritur këtë vizion, Strategjia parashikon katër fusha prioritare të veprimit: 1. Zvogëimi i migrimeve neto të jashtme; 2. Nxitja e natalitetit; 3. Zvogëlimi i pabarazive demografike midis vendbanimeve; dhe 4. Zhvillimi i kapitalit njerëzor. Si qëllime të veçanta kushtuar të rinjve, projekt-versioni i Strategjisë vë në dukje vetëm përmirësimin e mundësive për të adresuar çështjen e banimit të të rinjve; por vetë teksti i strategjisë thekson se synimi i të rinjve në të gjitha masat dhe aktivitetet duhet të jetë prioritet.

Rënia e përqindjes së përgjithshme të të rinjve reflektohet gjithnjë e më shumë në tregun e punës dhe sistemin arsimor. Papunësia e të rinjve ka rënë në mënyrë drastike, por mbetet e lartë.

Tregu i punës ka pësuar ndryshime të rëndësishme në dy dekadat e fundit. Sipas të dhënave të regjistrimit, nga viti 2002 deri në vitin 2021, numri i popullsisë punëtore është ulur me 171.317 banorë, ose 12,4%, ndërsa numri i të moshuarve mbi 65 vjeç është rritur me 17,2% ose me 101.619 persona. Për shkak të ndryshimeve të tilla, ekonomia gradualisht po ndryshon nga një pozicion i një tregu të dobësuar të punës me tepicë të punës në të kaluarën, në një ekonomi ku punëdhënësit raportojnë mungesë të punëtorëve.

Megjithëse vendi ka parë një rënie të konsiderueshme të papunësisë së të rinjve në vitet e fundit, ajo mbetet pothuajse dy herë më e lartë (33%) sesa ajo e popullsisë së përgjithshme (16,6%) dhe papunësia e të rinjve në kuadër të BE-së (14,7%). Pavarësisht disa përmirësimeve caktuara, shkalla e punësimit të të rinjve mbetet relativisht e ulët (35%) dhe shumë më poshtë se ajo e popullsisë së përgjithshme (61%). Të rinjtë në Maqedoninë e Veriut gjithashtu kanë nivele shumë më të ulëta të punësimit në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga BE dhe disa nga vendet fqinje.⁶ Sipas Anketës për fuqinë punëtore nga viti 2021, afërsisht 94 000 të rinj të moshës 15-29 vjeç nuk janë të punësuar dhe nuk janë të përfshirë në arsim ose trajnim (NEET), që korrespondon me afërsisht një të katërtën (24,2% përqind) të popullsisë

6 Mojsoska-Blazeski, N. (2023). North Macedonia Education Sector Analysis. Chapter 4: Relevance of Education for Labour Market Inclusion. Paris: UNESCO IIEP.

së re të përgjithshme (26,1% për gratë). Kjo përqindje shënon një tendencë në rënie krahasuar me vitin 2016, kur personat e rinj NEET përbënin 31,3% të popullsisë së re (afërsisht 136 000 të rinj). Kjo rënie është pjesërisht për shkak të uljes graduale të popullsisë së re në Maqedoninë e Veriut, por edhe për efektet e futjes së Garancisë për të rinj (pjesa e personave të rinj NEET u ul nga 29,7% në vitin 2018 në 24,5% në vitin 2019). Në përgjigje të disa prej këtyre sfidave, plani për zbatimin e Garancisë për të rinj 2023-2026 prezanton risitë, ku fokusi është te personat e rinj NEET, respektivisht personat e moshës 15-29 vjeç, të cilët nuk janë në procesin e arsimit, nuk janë të punësuar dhe nuk janë të përfshirë në disa nga trajnimet. Çmimi i përgjithshëm i zbatimit të planit vlerësohet në 3.807.449.0070 MKD (55.710.570 EUR), me afërsisht 89% të financuara nga buxheti nacional.

Është gjithashtu karakteristike që me rënien e numrit të të rinjve, po zvogëlohet edhe numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme. Në 10 vitet e fundit, numri i nxënësve në arsimin fillor është ulur për 6%, ndërsa në arsimin e mesëm për 30%.⁸ Pavarësisht rënies së ndjeshme të numrit të nxënësve në dekadën e fundit, numri i mësuesve të punësuar në kuadër të arsimit fillor dhe të mesëm po rritet vazhdimisht. Për shembull, midis viteve 2009 dhe 2019, vetëm 8 komuna (nga gjithsej 80) kishin një rritje të numrit të nxënësve, ndërsa në të njëjtën kohë, të gjitha rritën numrin e mësuesve, gjë që tregon se vendimet për punësimin e mësuesve nuk ndiqen nga logjika e qëndrueshme ekonomike dhe nuk bazohen në nevoja reale.⁹ Rekomandimet e Bankës Botërore¹⁰ dhe UNICEF-it¹¹ tregojnë se rënia demografike kërkon një sërë masash për riorganizimin dhe optimizimin e rrjetit shkollor në vend dhe shtrëngimin e punësimit të mësuesve me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të mjeteve në arsim.

7 Plan i zbatimit e Garancisë për të rinj 2023-2026.

8 Vergas, G. (2023). North Macedonia Education Sector Analysis. Chapter 2: Schooling patterns. Paris: UNESCO IIEP.

9 Naceva, B., Shimbov, B. dhe Galevski, M. (2023). Financimi i së ardhmes sonë: si të përmirësojmë efikasitetin e shpenzimeve për arsimin në Maqedoninë e Veriut. Shkup: Banka Botërore.

10 Ibid.

11 UNICEF (2022). Are schools fit for purpose. The extent to which North Macedonia is getting the most out of the country's education resources. Shkup: UNICEF.

Kriza e shkaktuar nga virusi KOVID-19 po jep efektet e saj. Pasojat me të cilat përballen të rinjtë tani janë humbje të mëdha në mësim.

Mungesa e arsimit cilësor është një nga parametrat kryesorë që ndikon negativisht në pjesëmarrjen e të rinjve në tregun e punës. Për shembull, ndërsa të rinjtë më shpesh do të zgjidhnin të punonin në profesione që janë në përputhje me arsimin e tyre, më shumë se gjysma e tyre punojnë në profesione në të cilat nuk janë arsimuar, gjë që tregon hendekun midis arsimit formal dhe tregut të punës.¹²

Rezultatet e testimit ndërkombëtar të PISA-s të kryer në vitin 2022 tregojnë se nxënësit maqedonas në moshën 15 vjeç kanë mbetur prapa në edukimin gjuhësor, matematikë dhe shkencat natyrore. Nga gjithsej 81 shtete në të cilat u krye matja e njohurive të nxënësve, nxënësit maqedonas rradhiten në vendin e 61-të në rezultatet e matematikës, në vendin e 71-të në edukimin gjuhësor dhe në vendin e 68-të në shkencat natyrore. Respektivisht, tre të katërtat (74%) e nxënësve 15-vjeçarë në Maqedoninë e Veriut kanë rezultate të dobëta në edukimin gjuhësor, ndërsa dy nga tre nxënës tregojnë rezultate të dobëta në matematikë (64%) dhe shkenca natyrore (65%).

Krahasuar me vitin 2018, rezultatet e nxënësve në Maqedoninë e Veriut janë në rënie, megjithëse duhet të theksohet se shumica e shteteve po përjetojnë rezultate më të këqija, gjë që ndoshta është për shkak të pandemisë të shkaktuar nga virusi KOVID-19. Gjatë kohës të krizës të shkaktuar nga virusi Kovid-19, Maqedonia e Veriut u përball me një nga mbylljet më të gjata të shkollave (më e gjata në krahasim me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor) pavarësisht rekomandimeve se do të kishte pasoja serioze në suksesin e nxënësve. Në vendin tonë, shkollat u mbyllën për 54 javë, krahasuar me 24 javë sa ishte mesatarja në kuadër të Evropës dhe Azisë Qendrore.

Krahasuar me shtetet e rajonit, 15-vjeçarët nga Maqedonia e Veriut janë vetëm më të mirë se bashkëmoshatarët e tyre në Kosovë dhe Shqipëri, ndërsa ata janë shumë prapa studentëve nga Sllovenia dhe Kroacia, të cilët janë përpara në rajon sipas rezultateve të PISA 2022. Sipas UNICEF-it, kriza në të mësuarin në vend është rezultat i dekadave të zgjidhjes joadekuate të sfidave kryesore strukturore, mungesës së vazhdimësisë në proceset e reformave nga qeveri të ndryshme dhe dështimit për të përqendruar arsimin në nevojat reale dhe individuale të nxënësve.¹³

12 Bozivic-Stojkoska, S., Trojancanec, M. dhe Shabani, D. (2023). Aspiratat rinore për karrierë dhe aftësi.

13 <https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/soop%C5%A1tenija/visoka-e-cenata-%C5%A1to-%E1%B8%B1e-ja-platime-ako-krizata-so-u%C4%8Denjeto-ne-stane-nacionalen-prioritet>

Cilësia e jetës së të rinjve, një nga më të këqijat në rajon

Në kuadër të Indeksit të fundit global të zhvillimit rinor (2023)¹⁴ që mat cilësinë e jetës së të rinjve në mbarë botën, Maqedonia e Veriut u radhit e 57-ta nga 153 shtete në të cilat kryhet matja. Me një rezultat prej 74,59 pikësh (11 pikë më pak se mesatarja e Bashkimit Evropian), Maqedonia e Veriut është në grupin e vendeve që kanë rezultate “në kuadër të pritshmërive”. Krahasuar me vendet e rajonit, Maqedonia e Veriut ka rezultate pak më të mira se Bosnja dhe Hercegovina (vendi 58) dhe Shqipëria (60), dhe qëndron më keq se të gjitha vendet e tjera, duke përfshirë Slloveninë (17), Kroacinë (32), Serbinë (42), Bullgarinë (44) dhe Malin e Zi (45). Në kuadër të tre parametrave të ndryshëm që mbulon indeksi – nevojat themelore të njeriut, bazat e mirëqenies dhe mundësitë – Maqedonia e Veriut është e fundit në rajon sipas parametrin “bazat e mirëqenies”, sipas “nevojave themelore të njeriut” ajo është në mes të shteteve të rajonit, ndërsa është ndër tre shtetet më të këqija sipas parametrin “mundësitë”.¹⁵

Nuk janë ndarë mjete të mjaftueshme për të rinjtë dhe politikat rinore. Buxheti nacional për vitin 2024 parashikon rritje të investimeve në arsim.

Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore¹⁶ (LPRPR), i cili u miratua në janar të vitit 2020, rregullon një sërë aspektesh të rëndësishme që lidhen me të rinjtë dhe jetën e tyre, duke përfshirë format e organizimit të të rinjve, pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së të rinjve, si dhe miratimin e dokumenteve strategjike që lidhen me të rinjtë në nivel lokal dhe qendror. Tre vjet pas miratimit të tij, zbatimi i tij mbetet në një nivel të ulët dhe shumë prej mekanizmave të parashikuar nuk janë zbatuar ende. Në disa raste, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e institucioneve (si Kuvendi dhe Agjencia për rini dhe sport) kanë theksuar nevojën për ndryshime në LPRPR në të ardhmen e afërt.

14 Në dispozicion në: <https://youthprogressindex.org/>

15 Për më shumë, shih: Radio MOF (20 tetor, 2023). *Maqedonia e Veriut ndër më të këqijat në rajon sipas Indeksit të ri të zhvillimit rinor.*

16 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 10/2020

Sipas të dhënave nga monitorimi¹⁷ i dytë mbi zbatimin e LPRPR të kryer nga Këshilli rinor nacional i Maqedonisë¹⁸, megjithëse ka disa përmirësime të caktuara në krahasim me monitorimin e parë, komunat ende tregojnë pak interes në zbatimin e detyrimeve ligjore për krijimin e një këshilli rinor lokal, zyrës për të rinj dhe/ose qendrës rinore. Vetëm për sa i përket emërimit të një nëpunësi për të rinj (79% e komunave kanë nëpunës për të rinj) ka përfshirje të kënaqshme në nivel lokal. Në raport gjithashtu theksohet se vetëm 19 komuna kanë formuar një këshill rinor lokal, 7 komuna kanë formuar qendra rinore dhe 14 janë në fazën e formimit. Për më tepër, strategjitë lokale për të rinj janë miratuar në vetëm 7 komuna.

Në nivel nacional, ka gjithashtu një ngërç në zbatim. Në fakt, Kuvendi nacional për të rinj dhe Trupi nacional këshilldhënës nuk janë themeluar ende, kurse Qendra hulumtuese për temat që lidhen me të rinjtë nuk është themeluar në Agjencinë për të rinj dhe sport (ARS). Një hap pozitiv përpara është angazhimi për të miratuar një Strategji të re nacionale për të rinj, e cila u miratua në shtator të vitit 2023.¹⁹

Vërejtje të ngjashme janë regjistruar në analizën mbi financimin e politikave rinore të realizuara nga Fondacioni për demokraci të Uestminsterit²⁰, e cila gjithashtu tregon sfidën e ndjekjes të shpenzimeve për shkak të mospërputhjeve në ligj për atë se cilat mjete konsiderohen mjete të ndara për zbatimin e LPRPR. Për më tepër, mangësia thelbësore e këtij ligji është mungesa e dispozitave që rregullojnë mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi zbatimin e ligjit, gjë që sjell vonesa dhe zbatim të pabarabartë të ligjit nga subjektet kompetente. Në ligj, siç vëren analiza, nuk përcaktohet se çfarë do të ndodhte nëse buxheti planifikon dhe ndan mjete, por ato nuk realizohen plotësisht ose nuk realizohen aspak. Sipas kësaj analize, buxheti i përgjithshëm i ARS, e cila është organi kryesor që duhet të kujdeset për politikën rinore, arrin në 0,2% të shpenzimeve të përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (periudha nga viti 2020 deri në vitin 2022). Pjesa më e madhe e shpenzimeve të ARS bien në shpenzimet për sport (80% e shpenzimeve të përgjithshme). Shpenzimet e programit të rinjtë janë dukshëm më të ulëta dhe variojnë nga 3,9% në 5,2% të shpenzimeve të përgjithshme të ARS në periudhën e analizuar. Krahasuar me Buxhetin e

17 Monitorimi i parë i referohet vitit 2022, ndërsa monitorimi i dytë për vitin 2023.

18 Kulakov, F. (2023). Raporti i monitorimit 2023 për zbatimin e Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore. Shkup: Këshilli rinor nacional i Maqedonisë.

19 Afati ligjor për miratimin e tij është korriku i vitit 2021.

20 Shapkova-Kocevska, K. (2023). Financimi i politikave rinore. Analiza e mjeteve të ndara për Ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore në vitin 2022. Shkup: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit.

RMV, shpenzimet e ARS në lidhje me programin të rinjtë arrijnë në 0,008% të shpenzimeve të përgjithshme të Buxhetit. Sa i përket financimit në nivel lokal, është përcaktuar se vetëm 16 komuna (20% e numrit të përgjithshëm të komunave) realizuan një transaksion ndaj formës të caktuar të organizimit rinor (FOR) në vitin 2022.²¹

Analizat fillestare²² të propozim-buxhetit për vitin 2024, i cili u miratua nga Qeveria, tregojnë se mjetet për të rinjtë do të zvogëlohen më tej. Me propozim ligj parashihet që financimi i ARS-së të zvogëlohet për 16%, respektivisht 54 milionë denarë më pak se në vitin 2023. Shkurtimi është në të gjitha programet, por më drastikisht në zërin të rinjtë, i cili planifikohet të zvogëlohet për një të tretën, nga 21,8 milion denarë në vitin 2023 në 14,6 milion denarë në vitin 2024. Shkurtime të tilla do të zvogëlojnë pjesën tashmë të vogël të Programit për të rinj në buxhetin e përgjithshëm të agjencisë dhe do të rrezikojnë financimin e fushave prioritare në Strategjinë nacionale për të rinj të miratuar rishtazi (2023-2027).

Me propozim-buxhetin për vitin 2024, buxheti i Ministrisë së arsimit dhe shkencës (MASH) është planifikuar të rritet me 3,75 miliardë denarë, përkatësisht 13% krahasuar me buxhetin e vitit 2023. Sipas analizës së Radio MOF(FRA)²³, rritja është kryesisht për shkak të zërit të decentralizimit, i cili në pjesën më të madhe përfshin rrogat dhe shtesat për të punësuarit në shkollat fillore dhe të mesme, të cilat janë rritur ndërkohë, ndërsa përqindja më e madhe është në zërin investimet në arsim (+44%), si dhe në standardin e nxënësve, në arsimin fillor dhe të mesëm, të cilat po rriten me rreth një të tretën. Rënie vërehet në zërin standard i studentëve, i cili zvogëlohet me pothuajse 10%, si dhe në paratë e parashikuara për shkencën, i cili është 5% më pak në krahasim me Buxhetin për vitin 2023.

Është miratuar një Strategji e re nacionale për të rinj 2023-2027

Në shtator të vitit 2023, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi dhe miratoi Strategjinë e tretë nacionale për të rinj 2023-2027 me një plan për veprimi për vitet 2023-2025.²⁴ Strategjia përcakton qëllimet

21 Ligji njej katër forma të FOR-së: organizatat rinore, organizatat për të rinj, organizatat ombrellë rinore dhe Kuvendi nacional për të rinj.

22 Radio MOF (20 nëntor 2023). Më pak para për të rinjtë, shkencën dhe ekologjinë – Cili është propozimi i buxhetit për vitin 2024. <https://www.radiomof.mk/pomalku-pari-za-mladi-nauka-i-ekologija-shto-predviduva-predlog-budzhetet-za-2024-infografik/>

23 Ibid.

24 "Gazeta Zyrtare" nr. 204, datë 29.09.2023.

dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin e politikave rinore dhe avancimin e interesave të të rinjve në shtet. Imperativi kryesor i Strategjisë është avancimi i pozitës së të rinjve në shoqëri duke vendosur parimet themelore të veprimit dhe qëllimet dhe masat që ofrojnë një kornizë reformuese kryesisht për institucionet, por edhe aktorët e tjerë në aftësimin e të rinjve për të ushtruar të drejtat, nevojat dhe interesat e tyre.

Strategjia nacionale për të rinj 2023-2027 mbulon tetë fusha prioritare: 1. Pjesëmarrja rinore; 2. Informimi rinor; 3. Puna rinore; 4. Arsimi; 5. Kultura; 6. Shëndeti; 7. Sipërmarrja dhe mbështetja para punësimit; dhe 8. Siguria (dhuna) si një temë e re që nuk ishte lëndë e strategjive të mëparshme për të rinj. Në kuadër të fushave prioritare janë përfshirë një numër temash dhe sfidash horizontale siç janë: barazia gjinore, avancimi i mjedisit jetësor, përballje me krizat dhe shokun (si COVID-19), pjesëmarrja në jetën demokratike, anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe transformimi digjital. Në drejtim të përcaktimit të qëllimeve dhe masave, merren parasysh edhe politikat dhe parimet që janë inkuadruar në Strategjinë evropiane për të rinj 2019-2027 si dhe Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Më shumë se 1.300 të rinj dhe përfaqësues të institucioneve morën pjesë në krijimin e Strategjisë. Strategjia për herë të parë përfshin tregues për matjen e suksesit në të tetë fushat që janë pjesë e strategjisë.

Te shumica e të rinjve mbizotërojnë stereotipet dhe paragjykimet gjinore

Sipas një analize të barazisë gjinore përmes prizmit të të rinjve²⁵, më shumë se 90% e të rinjve në Maqedoninë e Veriut, pavarësisht nga gjinia, kanë dëgjuar për nocionin barazi gjinore, por vetëm një pjesë e vogël e tyre e kuptojnë rëndësinë e saj dhe përfitimet që sjell barazia gjinore. Përveç kësaj, megjithëse vetëdija për stereotipizimin gjinor është i zhvilluar mirë në shumicën e të rinjve (tre të katërtat e të rinjve mendojnë se ka stereotipe gjinore në vend), kjo nuk pengon përfaqësimin e stereotipeve. Gati dy të tretat e të rinjve të anketuar besojnë se stereotipet gjinore janë të pranishme në mjedisin e tyre më të afërt, ndërsa çdo i treti i ri ka përjetuar personalisht sjellje stereotipike gjinore dhe ndikimet negative të saj, me më shumë stereotipe gjinore që përjetohej nga gratë e reja dhe të rinjtë nga komunitetet etnike të pakicave. Në të njëjtën kohë, gjetjet nga hulumtimi çojnë në faktin se bindjet më të stereotipizuara gjinore tek të rinjtë janë në aspektin e aktivitetit politik dhe pjesëmarrjes në vendimmarrjen e grave. Përveç kësaj,

25 Trajanovska, Lj. (2023). Analiza e (pa) barazive gjinore përmes prizmit të të rinjve në Maqedoninë e Veriut. Shkup: Këshilli rinor nacional i Maqedonisë dhe Shoqata për mundësi të barabarta "Rrjeti Stella".

është shqetësuese që 60% e të rinjve të anketuar besojnë se gratë janë të destinuara për kujdesin e fëmijëve dhe familjes. Sa i përket hapësirës ku shfaqen më shpesh paragjykimet dhe stereotipet gjinore, burimet kryesore janë familja, mediat sociale dhe arsimiti.

Lidhur me faktorët që mbështesin barazinë gjinore dhe kohezionin social, hulumtimi i kryer në vendet e Ballkanit Perëndimor përmes një metode të kombinuar²⁶, tregon se shumica e të rinjve e njohin rolin e rëndësishëm të barazisë gjinore në kontributin për kohezionin social dhe ndërtimin e një shoqërie më të drejtë. Megjithatë, disa të rinj ende e shohin barazinë gjinore si kundërproduktive për arritjen e kohezionit social. Lidhur me perceptimet e të rinjve për çështjen se cilët faktorë ndihmojnë për një shoqëri më të fortë dhe më të drejtë, opsionet më të njohura në të gjithë rajonin janë qasja e barabartë në arsim cilësor dhe mundësitë e barabarta të punës. Barazia gjinore është në vendin e tretë, e lidhur ngushtë me qasjen e barabartë në kujdesin shëndetësor. Për më tepër, analiza tregon se pengesat dhe sfidat më të mëdha për barazinë gjinore dhe kohezionin social janë trashëgimia negative e së kaluarës, rolet tradicionale gjinore, pritjet sociale të grave dhe burrave, maskuliniteti hegjonik dhe toksik, dhuna me bazë gjinore, gjuha e urrejtjes dhe korrupsioni.

Përkundër sfidave të tilla, shteti ende nuk ka futur edukimin formal seksual në shkollat fillore dhe të mesme. Në vitin 2021, në kuadër të tre atyre themelore, u zbatua programi pilot për edukimin gjithëpërfshirës seksual (EGJS). Vlerësimi i programit të kryer nga Byroja për zhvillimin e arsimit, në bashkëpunim me HERA – Shoqata për edukim shëndetësor dhe hulumtim, tregon se nxënësit e përfshinë dinë shumë më tepër për shëndetin dhe të drejtat e tyre seksuale dhe riprodhuese sesa shokët e tyre të klasës në shkollat e tjera në të gjithë vendin. Gjithashtu është hartuar një projekt-version i Strategjisë nacionale për EGJS për periudhën 2023-2028 dhe ende nuk është miratuar.

Shpërndarja e qëndrimeve homofobike dhe ndikimi i tyre në ekonomi

Sipas rezultateve të Hulumtimit sociale evropiane (HSE), i cili u krye për herë të parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në 2021–2022, qytetarët maqedonas jetojnë në një nga vendet më homofobike në rajon. Niveli i lartë i homofobisë në popullatën e përgjithshme konfirmohet nga hulumtimi i

²⁶ UN Women (2023). Voices of Youth: Gender Equality and Social Cohesion in the Western Balkans. Serbia: UN Women.

mëvonshëm i bazuar në HSE, ku është më i përhapur në popullatën e moshuar dhe më i përhapur te burrat në krahasim me gratë.

Pasojat e diskriminimit dhe mospërfshirjes së komunitetit LGBTI në ekonomi janë të mëdha. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, ekonomia e Maqedonisë së Veriut do të merrte 64 milionë dollarë shtesë dhe prodhimi i brendshëm bruto vjetor (PBB) do të rritej mesatarisht me 0,6% nëse do të zvogëloheshin pengesat për hyrjen në tregun e punës për personat LGBTI që përballen me diskriminim për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor.²⁷

Shëndeti mendor te të rinjtë po bëhet gjithnjë e më i rrezikuar.

Një studim i fundit i UNICEF-it tregon se që nga fundi i pandemisë, përqindja e fëmijëve që përjetojnë ankth dhe depresion është rritur. Deri në 30% e fëmijëve të moshës 10 deri në 18 vjeç përjetojnë depresion dhe mbi 40% përjetojnë ankth. Sipas hulumtimit të HBSC²⁸ të vitit 2022, në lidhje me shëndetin e fëmijëve të moshës shkollore 11 deri në 15 vjeç, ka pasur gjithashtu një rritje të përqindjes së atyre që u ankuan për shqetësim psikosomatik një herë në javë, me vajzat në moshën 15 vjeç më të prekur (64%), ndërsa 37% e djemve u prekën nga i njëjti problem.

Për sa i përket variablave të tjerë demografikë, burrat informohen pak më shpesh sesa gratë (12,9% kundrejt 7,3%, për përgjigje "shpesh"). Edhe shqiptarët etnikë (15,9% kundrejt 8,0% të maqedonasve etnikë dhe 9,1% të grupeve të tjera etnike, respektivisht, për përgjigje "shpesh"). Sipas arsimit, ata me fakultet të përfunduar informohen më shpesh sesa ata pa fakultet të përfunduar (18,8% kundrejt 6,8% për përgjigjen "shpesh"). Të punësuarit në sektorin publik informohen më shpesh (26,1%, përgjigje shpesh), në krahasim me të punësuarit e sektorit privat (9,4%) dhe të papunët (4,1%). Gjithashtu, të rinjtë aktivë në shoqëri informohen shumë më shpesh (55,2% për përgjigjen "shpesh"), kundrejt të rinjve që deklarojnë se nuk janë aspak aktivë në shoqëri (3,3% për përgjigjen "shpesh"). Në fakt, aktiviteti qytetar ndahet si faktori më i rëndësishëm që ndikon në nivelin e informimit të të rinjtë.

Pasqyra 55: Sa shpesh ndiqni dhe jeni të interesuar për ngjarjet dhe zhvillimet socio-politike në vend? (sipas gjinisë, arsimit, përkatësisë etnike dhe statusit të punës - për përgjigjen "shpesh")






Të rinjtë informohen më shpesh nga rrjetet sociale, dhe si burim më të besueshëm ata i konsiderojnë informacionet që vijnë nga bisedat me të afërmit

Kur u pyetën “Cilat janë burimet kryesore të informimit që përdorni për ngjarjet dhe zhvillimet sociopolitike në vend?”, të anketuarit patën mundësinë të zgjedhin më shumë opsione. Burimi i përdorur më shpesh janë rrjetet sociale (31,1%), portalet e internetit (22%) dhe televizionet (19,4%). Bisedat me të afërmit janë gjithashtu një burim i rëndësishëm për një të pestën e të rinjve (19,1%). Gazetat e shtypura dhe radiot janë burimi më pak i shpeshtë i informimit (0,7%), më pak se personalitetet e njohura dhe personat me ndikimi (influencerët) (1,8%).

Pasqyra 56: Cilat janë burimet kryesore të informimit që përdorni për ngjarjet dhe zhvillimet sociopolitike në vend?



Burimi i përdorur më shpesh i informimit midis të gjitha grupmohave janë rrjetet sociale. Burimi i dytë më i përdorur janë portalet e internetit. Burimi i tretë i përdorur më shpesh janë bisedat me të afërmit dhe televizioni (në varësi të moshës).

Pasqyra 57: Burimet e informimit të përdorura më shpesh, (sipas moshës)

15-18 vjeç	19-24 vjeç	25-29 vjeç	30-35 vjeç
1. Rrjetet sociale (57,2 %)	1. Rrjetet sociale (64 %)	1. Rrjetet sociale (65,7 %)	1. Rrjetet sociale (70,7 %)
2. Portalet e internetit (31,6 %)	2. Portalet e internetit (46,6 %)	2. Portalet e internetit (47,0 %)	2. Portalet e internetit (53,2 %)
3. Televizioni/ bisedat me të afërmit (28,3 %)	3. Bisedat me të afërmit (38,1 %)	3. Bisedat me të afërmit (43,4 %)	3. Televizioni (52,7 %)


Sipas përkatësisë etnike, rrjetet sociale janë përsëri burimi më i përdorur midis të gjitha grupeve, por ka dallime të caktuara në burimet e dyta dhe të treta më të përdorura. Të anketuarit maqedonas dhe të anketuarit nga bashkësitë e tjera etnike preferojnë portalet e internetit dhe bisedat me të afërmit si burim i dytë dhe i tretë i informimit, ndërsa të anketuarit shqiptarë preferojnë televizionin dhe portalet e internetit.

Pasqyra 58: Burimet e informimit të përdorura më shpesh (sipas përkatësisë etnike)

Maqedonas	Shqiptar	Tjetër
1. Rrjetet sociale (66,9 %)	1. Rrjetet sociale (64,1 %)	1. Rrjetet sociale (62,8 %)
2. Portalet e internetit (46,6 %)	2. Televizioni (51,4 %)	2. Televizioni (47,1 %)
3. Bisedat me të afërmit (43,7 %)	3. Portalet e internetit (48,6 %)	3. Bisedat me të afërmit (43 %)


Pyetja e mëposhtme shqyrtoi burimet më të besuara nga të rinjtë. Në përgjithësi, pavarësisht nga burimi i informimit, të rinjtë nuk kanë shumë besim në besueshmërinë e tyre. Në një shkallë nga 1 deri në 5, të rinjtë më pak u besojnë liderëve politikë (nota 2,1) dhe institucioneve qeveritare (nota 2,2), ndërsa ata më së shumti u besojnë bisedave me të dashurit (nota 3,4) dhe deri diku ekspertëve (nota 2,9). Është mbresëlënëse se institucionet fetare (nota 2,7) kanë besim më të lartë se organizatat e shoqërisë civile (2,4%).

Pasqyra 59: Sa u besoni burimeve të mëposhtme të informimit në lidhje me ngjarjet dhe zhvillimet socio-politike në vend? (1=nuk u besoj aspak, 5= u besoj plotësisht)



Të dhënat e ndara si një kumulativ i notave 1 dhe 2 (“nuk u besoj aspak” dhe “shumë pak u besoj”) tregojnë se ka një mosbesim të përgjithshëm në mënyrën e qeverisjes së vendit nga liderët politikë, si dhe pakënaqësi me punën e institucioneve. Konkretisht, besimin më të ulët e gëzojnë liderët politikë dhe institucionet qeveritare. Pothuajse një e treta e të rinjve nuk u besojnë informacioneve që vjen nga këto dy burime. Gjithashtu është shqetësuese se saktësisht gjysma e të rinjve nuk u besojnë as informacioneve që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile.

Pasqyra 60: Sa u besoni burimeve të mëposhtme të informimit në lidhje me ngjarjet dhe zhvillimet socio-politike në vend? (Shuma e përgjigjeve 1 dhe 2 (“nuk u besoj aspak” dhe “shumë pak u besoj”), tre burimet kryesore me besimin më të ulët



Është gjithashtu interesante të theksohet se ekziston një pabarazi e qartë midis burimeve nga të cilat të rinjtë informohen më shpesh dhe burimeve të cilave u besojnë më shumë. Për ilustrim, megjithëse informohen më shpesh nga rrjetet sociale dhe portalet e internetit, ata u besojnë më shumë bisedave me të afërmit dhe ekspertët.

KATËR BURIMET KRYESORE TË INFORMIMIT:


1. Rrjetet sociale
2. Portalet e internetit
3. Televizionet
4. Bisedat me të afërmit

KATËR BURIMET KRYESORE TË CILAVE U BESONI:

1. Biseda me të afërmit
2. Ekspertët
3. Rrjetet sociale
4. Institucionet fetare
5. Portalet e internetit


Pyetja e fundit në këtë pjesë shqyrtoi se si të rinjtë vlerësojnë njohuritë e tyre për politikën dhe ngjarjet socio-politike në shtet. Pothuajse gjysma e të rinjve (42,6%) (shuma e përgjigjeve 1 dhe 2), nuk kanë aspak ose kanë shumë pak njohuri për politikën. Vetëm 5% e të rinjve kishin njohuri të shkëlqyera.

Pasqyra 61: Si do t'i vlerësonit njohuritë tuaja për politikën dhe ngjarjet sociopolitike në shtet?




Informimi i të rinjve dhe angazhimi i tyre social luajnë një rol kryesor në kuptimin e politikës dhe ngjarjeve socio-politike në shtet. Në mënyrë të veçantë, të rinjtë më të informuar dhe ata që janë aktivë në shoqëri kanë njohuri më të mira për politikën dhe ngjarjet sociopolitike.

Pasqyra 62: Si do t'i vlerësonit njohuritë tuaja për politikën dhe ngjarjet sociopolitike në shtet? / Sa shpesh ndiqni dhe jeni të interesuar për ngjarjet dhe zhvillimet socio-politike në vend?



Pasqyra 63: Si do t'i vlerësonit njohuritë tuaja për politikën dhe ngjarjet sociopolitike në shtet? / A do ta përshkruanit veten si një qytetar aktiv në aspekt social?




BESIMI TEK INSTITUCIONET DHE NDIKIMI PERSONAL

Grupi tjetër i pyetjeve kishte të bënte me besimin e të rinjve në institucione me theks të veçantë për kujdesin e institucioneve për nevojat dhe problemet e të rinjve dhe mundësitë për ndikim personal.

Të rinjtë ndihen të lënë jashtë prioriteteve të institucioneve dhe mendojnë se institucionet nuk janë të vetëdijshëm për problemet e tyre


Rezultatet e hulumtimit tregojnë se 8 nga 10 të rinj shprehin mosbesim se institucionet kujdesen për ta dhe nevojat e tyre, ndërsa vetëm një pakicë e të rinjve (13,9%) besojnë se institucionet e bëjnë këtë. Këto të dhëna tregojnë se shumica e të rinjve ndihen të injoruar nga institucionet dhe nuk besojnë se nevojat dhe problemet e tyre janë një përparësi e veçantë për institucionet.

Pasqyra 64: Sipas mendimit tuaj sa mendoni se kujdesen institucionet për ju, nevojat dhe problemet tuaja?




Lidhur me moshën, pakënaqësia me trajtimin e institucioneve është e lartë midis të gjitha nëngrupeve të moshës, dhe më e theksuar tek të rinjtë nga 19 deri në 24 vjeç.

Pasqyra 65: Sipas mendimit tuaj sa mendoni se kujdesen institucionet për ju, nevojat dhe problemet tuaja? (sipas moshës)




Lidhur me përkatësinë etnike, pakënaqësia më e theksuar me kujdesin e institucioneve është e dukshme te të anketuarit maqedonas etnikë dhe të anketuarit nga grupe më të vogla etnike.

Pasqyra 66: Sipas mendimit tuaj, sa kujdesen institucionet për ty dhe nevojat dhe problemet tua? (sipas përkatësisë etnike)




Analiza e trendit që ofron një krahasim të rezultateve me hulumtimet e mëparshme tregon se nuk ka zhvendosje në drejtimin pozitiv për sa i përket perceptimit të të rinjve se sa institucionet kujdesen për ta dhe nevojat dhe problemet e tyre. Në hulumtimin e këtij viti, vetëm 1,1% e të rinjve mendojnë se institucionet kujdesen plotësisht për ta.

Pasqyra 67: Sipas mendimit tuaj sa mendoni se kujdesen institucionet për ju, nevojat dhe problemet tuaja? (Analiza e trendit)




Mungesa e njohurive të institucioneve për nevojat dhe problemet e të rinjve është gjithashtu e lartë. Madje 7 nga 10 të rinj mendojnë se institucionet janë pjesërisht ose aspak të njohur për nevojat dhe problemet e tyre. Rreth një e katërta e të rinjve në vend mendojnë se institucionet janë plotësisht ose mjaft të njohura me nevojat dhe problemet e të rinjve.

Pasqyra 68: Sa i njohin institucionet nevojat dhe problemet tuaja si i ri?




Mungesa e njohurive të institucioneve për nevojat e të rinjve ndryshon në varësi të rajonit në të cilin jetojnë të rinjtë. Madje 97,8% e të rinjve që jetojnë në rajonin planor lindor thonë se institucionet janë vetëm pjesërisht ose aspak të vetëdijshëm për nevojat dhe problemet e tyre

Pasqyra 69: Sa i njohin institucionet nevojat dhe problemet tuaja si person i ri? (sipas rajoneve)




Njohja disi më e mirë e nevojave dhe problemeve të tyre nga institucionet, siç pritet, tregohet nga të rinjtë që janë anëtarë të një lloj organizate dhe të rinjtë që janë anëtarë të partive politike.

Pasqyra 70: Sa i njohin institucionet nevojat dhe problemet tuaja si person i ri? (sipas anëtarësisë në një organizatë)




Pasqyra 71: Sa i njohin institucionet nevojat dhe problemet tuaja si person i ri? (sipas anëtarësisë në parti politike)



Hulumtimi i këtij viti, krahasuar me ato të mëparshmit, nuk shënon ndryshime në përqindjen e qytetarëve të rinj që besojnë se institucionet nuk kanë “aspak njohuri” ose “pjesërisht nuk kanë njohuri”, gjë që nënvizon edhe një herë ndjenjën e tyre se institucionet nuk janë njohur në mënyrë adekuatë me atë që “i mundon” të rinjtë.

Pasqyra 72: Sa i njohin institucionet nevojat dhe problemet tuaja si i ri? (analiza e trendit)




Të rinjtë nuk kanë besim të lartë në asnjë institucion/organizatë...

Për të matur besimin që të rinjtë kanë në një numër aktorësh të rëndësishëm për politikat rinore dhe rrjedhat e përgjithshme shoqërore në vend, të anketuarve iu kërkua të vlerësojnë një sërë institucionesh dhe organizatash përkatëse për sa i përket punës së tyre në interes të të rinjve. Rezultatet tregojnë se besimi i të rinjve në aktorët shoqërorë është në një nivel shumë të ulët, gjë që tregohet nga rezultatet shqetësuese të ulëta të të gjitha institucioneve dhe organizatave të rradhitura.

Të shprehura në një shkallë nga 1 deri në 5 (ku 1 = e pakënaqshme dhe 5 = e shkëlqyer), më të ulëtat e vlerësuara nga të rinjtë janë Kuvendi (nota mesatare 1,8), partitë politike (nota mesatare 1,9) dhe Qeveria (nota mesatare 1,9), ndërsa më të vlerësuarat janë institucionet arsimore (nota mesatare 2,4), organizatat rinore (nota mesatare 2,3) dhe institucionet fetare (nota mesatare 2,3). Asnjë nga institucionet/organizatat e rradhitura nuk arriti të marrë një notë më të lartë prej 2,5 ose më shumë nga të rinjtë, respektivisht


asnjë institucion/organizatë nuk gëzon besim të moderuar ose të lartë të të rinjve.

Pasqyra 73: Në shkallë nga 1-5 ku 1=pamjaftueshëm, kurse 5=shkëlqyeshëm vlerësoni institucionet dhe organizatat e ardhshme në raport me punën e tyre në interes të të rinjve.



Krahasuar me tre hulumtimet e mëparshme, analiza e trendit tregon një rënie të vazhdueshme të vlerësimeve tashmë të ulëta të dhëna nga të rinjtë. Në fakt, krahasuar me hulumtimin e parë në vitin 2019, ka pasur një rënie të notës mesatare prej 0,3 deri në 0,5 pikë. Është interesante se institucionet fetare janë të vetmet ku nuk ka ndryshime të rëndësishme në besim.


Pasqyra 74: Në shkallë nga 1-5 ku 1=pamjaftueshëm, kurse 5=shkëlqyeshëm vlerësoni institucionet dhe organizatat e ardhshme në raport me punën e tyre në interes të të rinjve (analiza e trendit)



...as nuk besojnë se mund të ndikojnë në punën e tyre


Niveli i ulët i besimit të të rinjve në institucionet dhe organizatat përkatëse mund të interpretohet edhe në aspektin e mungesës së mundësive që të rinjtë të ndikojnë se çfarë dhe si punojnë institucionet. Në këtë drejtim, 8 nga 10 të rinj mendojnë se ata nuk mund ose vetëm pjesërisht mund të ndikojnë në punën e institucioneve.

Pasqyra 75: Sa mendoni se mund të ndikoni personalisht mbi atë se çfarë dhe si funksionojnë institucionet?




Krahasuar me tre hulumtimet e mëparshme, nuk ka asnjë ndryshim pozitiv në mundësitë që të rinjtë të ndikojnë personalisht në punën e institucioneve.

Pasqyra 76: Sa mendoni se mund të ndikoni personalisht mbi atë se çfarë dhe si funksionojnë institucionet? (Analiza e trendit)



Analiza e kryqëzuar, siç pritet, tregon se të rinjtë që janë aktiv në shoqëri kanë diçka më shumë fuqi për të ndikuar mbi punët. Të rinjtë që janë pjesë e organizatave të shoqërisë civile dhe partive politike ndjejnë më shumë fuqi, por rreth një e katërta e tyre besojnë se nuk kanë ndonjë ndikim në punën e institucioneve. Kjo tregon se pavarësisht anëtarësismit ose pjesëmarrjes aktive në këto organizata, votat e tyre mund të mos jenë marrë seriozisht ose reflektuar në mënyrë adekuate në punën e institucioneve.

Pasqyra 77: Sa mendoni se mund të ndikoni personalisht mbi atë se çfarë dhe si funksionojnë institucionet? (sipas anëtarësisë në organizata)




PJESËMARRJA QYTETARE E TË RINJVE NË SHOQËRI

Në këtë pjesë të hulumtimit, pyetjet adresojnë shkallën e aktivitetit shoqëror midis të rinjve,

Pjesëmarrje e ulët e të rinjve në aktivitete sociale. Gjithnjë e më shumë të rinj janë pasivë

Në pyetjen “A do ta përshkruanit veten si një qytetar aktivë në shoqëri?”, 77,7% e të rinjve përshkruhen si joaktivë në shoqëri, nga të cilët 50,2% kanë mungesë të plotë të aktivizmit. Vetëm 2,8% e kanë përshkruar veten si vazhdimisht aktivë dhe 19,7% shtesë si kryesisht aktivë.


Pasqyra 78: A do ta përshkruanit veten si një qytetar aktivë në aspekt social?





Analiza sipas parametrave demografikë tregon disa dallime midis të anketuarve për sa i përket aktivitetit të tyre social (jo)aktivitet mbi gjininë, vendbanimin, moshën, përkatësinë etnike, punësimin dhe të ardhurat. Në fakt, një përqindje pak më e lartë e të rinjve që nuk janë fare aktivë vërehet te të anketuarat femra (54,5%), krahasuar me meshkujt (45,8%). Moshë gjithashtu luan një rol, me të rinjtë e moshës 15 deri në 18 vjeç që janë më joaktivë (65,2%) dhe të rinjtë e moshës 30 deri në 35 vjeç që janë më pak joaktivë (46,3%), por përqindja mbetet e lartë. Sipas përkatësisë etnike, më pak aktivë janë të rinjtë nga grupet e tjera (më të vogla) etnike me 57%, ndërsa

50,7% e të anketuarve maqedonas dhe 45,7% e të anketuarve shqiptarëve nuk janë aspak aktivë. Përqindja e të rinjve që nuk janë aspak aktivë është pothuajse dy herë më e lartë tek të rinjtë që punojnë në sektorin privat, të rinjtë që janë të papunë dhe kërkojnë punë dhe të rinjtë në procesin arsimor, në krahasim me të rinjtë që punojnë në sektorin publik. Të ardhurat gjithashtu luajnë një rol, ku të rinjtë me të ardhura nën mesatare janë pothuajse dy herë më joaktivë (59,5%) sesa të rinjtë me të ardhura mbi mesatare (30,4%).


Pasqyra 79: A do ta përshkruanit veten si një qytetar aktivë në aspekt social? (sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit të punës, arsimit dhe të ardhurave - përgjigja "Unë nuk jam aspak aktiv")






Është e habitshme se shkalla e aktivizmit rinor ndikohet nga mënyra se si të rinjtë e shohin drejtimin në të cilin po lëviz vendi, respektivisht, të rinjtë që besojnë se vendi nuk po lëviz në drejtimin e duhur janë shumë më pasivë se të rinjtë që besojnë se vendi po lëviz në drejtimin e duhur.

Pasqyra 80: A do ta përshkruanit veten si një qytetar aktivë në aspekt social? Në përgjithësi, punët në vend po ecin në drejtimin e duhur apo të gabuar?



Krahasuar me hulumtimet e mëparshme, numri i të rinjve që janë plotësisht pasivë po rritet.


Pasqyra 81: A do ta përshkruanit veten si një qytetar aktivë në aspekt social? (Analiza e trendit)




Për të kuptuar arsyet që dekurajojnë ose motivojnë të rinjtë të jenë aktivë në shoqëri, u bënë dy pyetje shtesë. Lidhur me pyetjen e parë, e cila shqyrton arsyet që dekurajojnë njerëzit joaktivë të bëhen aktivë, arsyeja kryesore është mosbesimi se përmes aktivizimit diçka mund të ndryshohet, gjë që thuhet nga pothuajse gjysma e të rinjve që janë joaktivë (45,6%), dhe fakti shqetësues se pothuajse një e treta e të rinjve nuk janë aspak aktivë sepse nuk ka interes të jenë aktivë (29,5%). Lidhur me pyetjen e dytë që hulumton se çfarë i motivon të rinjtë të jenë aktivë në shoqëri, rezultatet tregojnë se më së shpeshti aktiviteti lidhet me mundësitë për përmirësimin e së ardhmes (42,1%) dhe dëshirën për të dëgjuar zërin e të rinjve (29,2%).

Pasqyra 82: Cila është arsyeja kryesore që ju dekurajon ose ju motivon të jeni një qytetar aktivë në shoqëri?

Cila është arsyeja kryesore që ju dekurajon të jeni një qytetar aktiv në shoqëri?



Cila është arsyeja kryesore që ju motivon të jeni një qytetar aktiv në shoqëri?




Të rinjtë që tregojnë iniciativë janë të rrallë, dhe edhe më të rrallë janë të rinjtë që arrijnë të zgjidhin një problem social

Sa i përket asaj se sa shpesh të rinjtë bëjnë diçka për të zgjidhur një problem të caktuar shoqëror, rezultatet tregojnë se më shumë se gjysma e të rinjve (51,7%) kurrë nuk kanë bërë asgjë për të zgjidhur një problem të caktuar shoqëror. Nga ata që kanë ndërmarrë (45,6%), vetëm një pjesë e vogël e tyre janë vazhdimisht (2,1%) ose shpesh (13%) aktivë, dhe shumica janë rrallë aktivë (30,5%).


Në mesin e të rinjve që bëjnë diçka për të zgjidhur një problem të veçantë shoqëror, shumë pak arrijnë të zgjidhin problemet (afërsisht një e treta), ndërsa të rinjtë e tjerë rrallë (52,4%) ose kurrë (17,5%) nuk kanë sukses në përpjekjet e tyre.

Pasqyra 83: Sa shpesh ndërmerri diçka për zgjidhjen e problemit të caktuar shoqëror?/Sa shpesh keni arritur ta zgjidhni problemin?

Sa shpesh ndërmerri diçka për zgjidhjen e problemit të caktuar shoqëror?




Sa shpesh keni arritur ta zgjidhni problemin?




Krahasuar me hulumtimet e mëparshme, ekziston një tendencë e përsëritur rritëse në numrin e të rinjve që nuk janë përpjekur kurrë të zgjidhin një problem të caktuar social (një rritje prej 8,5% krahasuar me hulumtimin e vitit 2021). Te të rinjtë aktivë, megjithatë, nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm për sa i përket suksesit në zgjidhjen e problemeve sociale.

Pasqyra 84: Sa shpesh ndërmerrni diçka për zgjidhjen e problemit të caktuar shoqëror?/Sa shpesh keni arritur ta zgjidhni problemin? (Analiza e trendit)

Sa shpesh ndërmerrni diçka për zgjidhjen e problemit të caktuar shoqëror?




Sa shpesh keni arritur ta zgjidhni problemin?




Analizimi i përvojës së të rinjve lidhur me përfshirjen apo konsultimin nga institucionet në vendimmarrje, duke përjashtuar votimin në zgjedhje, tregon se tre të katërtat e të rinjve nuk janë përfshirë apo konsultuar nga institucionet deri më tani në vendimmarrje. Gjithsej 24% e të anketuarve theksojnë se janë konsultuar në një farë mënyre, nga të cilat 3% në nivel lokal dhe qendror, 3,4% vetëm në nivel qendror dhe 17,6% janë përfshirë ose konsultuar vetëm në nivel lokal.

Pasqyra 85: A jeni përfshirë apo konsultuar ndonjëherë deri tani nga institucionet në marrjen e vendimeve, duke përjashtuar votimin në zgjedhje?



Krahasuar me hulumtimin e mëparshëm (me përjashtim të hulumtimit të parë), nuk janë vërejtur ndryshime të rëndësishme në vëllimin ose format e përfshirjes së të rinjve.




Pasqyra 86: A jeni përfshirë apo konsultuar ndonjëherë deri tani nga institucionet në marrjen e vendimeve, duke përjashtuar votimin në zgjedhje? (Analiza e trendit)



Analiza sipas parametrave demografikë tregon se midis të rinjve që nuk përfshihen në asnjë nivel, ka dallime për sa i përket gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, vendbanimit dhe gjendjes financiare. Në fakt, më pak përfshirje vërehet te gratë, te të rinjtë e moshës 15 deri në 18 vjeç, te të rinjtë maqedonas dhe të rinjtë nga bashkësitë më të vogla etnike, të rinjtë nga zonat urbane dhe të rinjtë me të ardhura mesatare.

Pasqyra 87: A jeni përfshirë apo konsultuar ndonjëherë deri tani nga institucionet në marrjen e vendimeve, duke përjashtuar votimin në zgjedhje? (sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, vendbanimit dhe gjendjes financiare - përgjigje "Nuk jam përfshirë")






Pjesë e vogël e të rinve janë anëtarë të një forme të organizimit. Anëtarësimi në parti politike është më popullor sesa anëtarësimi në organizatat e shoqërisë civile.

Madje 3 nga 4 të rinj nuk i përkasin asnjë organizate ose forme tjetër të organizimit. Nga ata të rinj që janë aktivë në një formë të organizimit (25,6% e të rinjve), ata më së shpeshti e bëjnë këtë në kuadër të partive politike/ forumeve rinore politike (9,9%), dhe pothuajse dy herë më pak në organizatat qytetare ose rinore (5%) dhe iniciativat qytetare joformale (4,0%).

³⁶ Të rinjtë shqiptarë janë pak më shumë të konsultuar në nivel lokal (22,4%) krahasuar me të rinjtë maqedonas (16,8%) dhe të rinjtë nga grupet e tjera etnike (11,6%).


³⁷ Të rinjtë që jetojnë në fshat janë pak më shumë të konsultuar në nivel lokal (21,2%), krahasuar me të rinjtë nga zonat urbane (15,3%).

Pasqyra 88: Pjesëmarrja në organizata




Krahasuar me hulumtimet e mëparshme, ka një rënie të lehtë të të rinjve që marrin pjesë në organizata.

Pasqyra 89: Pjesëmarrja në organizata, (Analiza e trendit)



Në kuadër të atyre 25,6% e të rinjve që marrin pjesë në ndonjë formë të organizimit, një përqindje më e lartë janë burra, në përqindjen më të madhe të të rinjve nga 30 deri në 35 vjeç, kryesisht maqedonas etnikë dhe në një numër më të madh të të rinjve që jetojnë në zonat urbane.

Pasqyra 90: Pjesëmarrja në organizata (të anketuarit që deklaruan se janë pjesë e një forme të organizimit), (sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe vendbanimit)



Gjithashtu bëmë një analizë më të detajuar të karakteristikave të të rinjve që janë pjesë e organizatave të shoqërisë civile dhe të rinjve që janë pjesë e partive politike.

Vlen të përmendet se gratë janë më shpesh anëtare të organizatave të shoqërisë civile, ndërsa burrat janë më shpesh anëtarë të partive politike. Sa i përket moshës, si midis organizatave të shoqërisë civile ashtu edhe

partive politike, rreth gjysma e të rinjve që janë anëtarë të tyre janë nga 30 deri në 35 vjeç. Maqedonasit etnikë pothuajse dyfish më shumë marrin pjesë në organizatat e shoqërisë civile në krahasim me shqiptarët etnikë dhe pothuajse trefish më shumë pjesëmarrje në partitë politike në krahasim me shqiptarët etnikë. Analiza gjithashtu tregon se të rinjtë nga zonat urbane janë dy herë më shumë pjesë e organizatave qytetare sesa të rinjtë që jetojnë në zonat rurale. Sipas vendbanimit, ky dallim është shumë më i vogël për të rinjtë që janë anëtarë të partive politike.

Pasqyra 91: Pjesëmarrja në organizata (të anketuarit që deklaruan se janë pjesë e organizatave qytetare ose rinore), Sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe vendbanimit


Pasqyra 92: Pjesëmarrja në organizata (të anketuarit që deklaruan se janë pjesë partive politike), Sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe vendbanimit



VOTIMI NË ZGJEDHJE DHE MOTIVIMI PËR TË VOTUAR


Lidhur me shprehitë e votimit, nga të gjithë të anketuarit e kualifikuar, më shumë se gjysma e të rinjve votojnë rregullisht në zgjedhje (59%), 31% shtesë votojnë ndonjëherë, ndërsa vetëm 7% nuk votojnë kurrë.

Pasqyra 93: Sa shpesh votoni në zgjedhje?




Krahasuar me tre hulumtimet e mëparshme, zvogëlohet numri i të rinjve që deklarojnë se votojnë gjithmonë.

Pasqyra 94: Sa shpesh votoni në zgjedhje? (Analiza e trendit)




Në lidhje me shprehitë e votimit të të rinjve, të punësuarit e sektorit publik votojnë më shpesh. Më konkretisht, 78,3% e të punësuarve të sektorit publik votojnë gjithmonë, kundrejt 56,6% e të punësuarve të sektorit privat dhe të papunëve (37%).

Pasqyra 95: Sa shpesh votoni në zgjedhje? (sipas statusit të punës - përgjigjet në pyetjen "Unë votoj gjithmonë")




Lidhur me gjendjen financiare, më pak votojnë të rinjtë me të ardhura nën mesataren.

Pasqyra 96: Sa shpesh votoni në zgjedhje? (sipas gjendjes financiare - përgjigje në pyetjen "Votoj gjithmonë")



Sa i përket përkatësisë etnike, nuk ka dallime të veçanta në shprehitë e votimit.

Pasqyra 97: Sa shpesh votoni në zgjedhje? (sipas përkatësisë etnike - përgjigjet në pyetjen "Gjithmonë votoj")



Është mbresëlënëse që më së shpeshti dalin të votojnë ata të rinj që janë të kënaqur me gjendjen, respektivisht ata që mendojnë se shteti po lëviz në drejtimin e duhur. Mund të jetë për shkak të bindjes së tyre se vota e tyre ka ndikim dhe se dalja e tyre në zgjedhje mund të ketë një efekt pozitiv mbi

situatat. Në të njëjtën kohë, të pakënaqurit duket se bojkotojnë votimin, respektivisht nuk shohin mundësinë që përmes votimit të ndryshojnë drejtimin në të cilin po lëviz shteti.

Pasqyra 98: Sa shpesh votoni në zgjedhje? (sipas drejtimit në të cilin po lëviz vendi)

	Në drejtim të duhur	Në drejtim të gabuar	As në të duhur, as në të gabuar
Gjithmonë votoj	79,9 %	51 %	59,5 %
Ndonjëherë votoj	15,8 %	37,9 %	30,2 %
Nuk votoj	2,2 %	9,4 %	5,8 %

Përveç kësaj, është interesante të theksohet si një paradoks i caktuar se më shumë se gjysma (54,2%) e atyre të anketuarve që pajtohen deri diku ose plotësisht me deklaratën se “Të gjitha partitë janë të njëjta” ende theksojnë se ata gjithmonë votojnë. Te këta të rinj, mund të ketë një ndjenjë të përjetimit të zgjedhjeve si një përgjegjësi, sesa një mundësi për të ruajtur ose ndryshuar drejtimin në të cilin po lëviz shteti.

ARSIMI SI ELEMENT I SOCIALIZIMIT POLITIK: PËRPUTHSHMËRIA ME PËRMBAJTJET E TEKSTEVE SHKOLLORE

Arsimi formal konsiderohet si një faktor shumë ndikues mbi socializimin politik të rinjtë. Ajo që të rinjtë mësojnë për shoqërinë dhe politikën, si u prezantohen atyre dhe në çfarë mase ata inkurajohen të mendojnë në mënyrë kritike dhe të hapur, mund të ketë implikime të forta për mirëkuptimin dhe veprimin e tyre politik në të ardhmen. Në fakt, përvojat e të rinjve në procesin arsimor ndikojnë drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në pikëpamjet e tyre për sistemin politik dhe në zhvillimin e vetëdijes kritike ndaj politikës, shtetit dhe lirive.


Në rastin e Maqedonisë së Veriut, në vitet e fundit ka pasur përpjekje për të futur dhe përmirësuar arsimin qytetar në shkollat fillore dhe të mesme duke e mësuar lëndën e arsimit qytetar dhe duke futur programe mësimore moderne për të. Hapat e tillë vijnë pas kritikave të shumta në të kaluarën që theksonin se disa nga tekstet e arsimit qytetar përmbanin përmbajtje që promovonin një qëndrim jokritik ndaj autoriteteve dhe institucioneve. Për shembull, në tekstin e klasës së tetë nën përkufizimin e “qytetarëve besnikë” thuhej se ata janë “gjithmonë të gatshëm të ndjekin rregullat dhe rregulloret e shoqërisë edhe nëse çmimi është të heqin dorë nga liritë e tyre” duke treguar dëgjueshmëri edhe me çmim të rrezikimit të të drejtave themelore civile dhe politike të qytetarit në një shoqëri demokratike dhe kontribuon në promovimin e kulturës politike qytetare dhe përforcon pasivizimin e qytetarëve. Në mënyrë të ngjashme, në të njëjtin tekst shkollor, puthja e dorës së më të rriturve u shpjegua si shprehje e respektit ndaj autoritetit. Ka disa shembuj³⁸ të tjerë të ngjashëm me të cilat tekstet shkollore inkurajojnë botëkuptime të vjetruara të normave shoqërore.

Të nxitur nga natyra problematike e deklaratave të tilla në tekstet shkollore, si pjesë e këtij hulumtimi, vendosëm të testojmë shkallën e pajtueshmërisë të të rinjtë me disa prej tyre. Ne përzgjedhëm gjithsej pesë deklarata të tilla të nxjerra nga botimet e teksteve shkollore për arsimin

38 Për shembull, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/26650031.html> <https://sdk.mk/index.php/makedonija/siromashnite-se-nesposobni-zhenite-ragaat-perat-i-shiat-a-mazhite-koi-pomagaat-doma-se-papuchari-i-slabichi-stoi-vo-diskriminirachkiot-uchebnik-po-sotsiologija-za-treta-godina/>

fillor dhe të mesëm, shumica e të cilave janë jashtë përdorimit sot. Duhet të theksohet se duke përfshirë deklaratat, ne nuk matim drejtpërdrejtë nëse të rinjtë kanë fituar qëndrime të caktuara në bazë të këtyre përmbajtjeve, por hulumtojmë përputhshmërinë me deklaratat që ishin pjesë e përmbajtjeve arsimore.

Pasqyra 99: Sa pajtoheni ose nuk pajtoheni me deklaratat e mëposhtme




Lidhur me deklaratën se “Homoseksualiteti është sjellje devijante”³⁹, që tregon heteronormativitet, ku personat LGBT paraqiten negativisht, më shumë se gjysma e të rinjve, ose 54,7%, pajtohen me këtë deklaratë. Një aspekt tjetër shqetësues është se qëndrime të tilla janë pothuajse të pranishme në mënyrë të barabartë në të anketuarit më të rinj, gjë që tregon se këto stereotipe dhe paragjykime janë të vazhduara dhe mjaft konstante në gjenerata të ndryshme. Zakonisht, sipas hulumtimeve të kryera në vende të tjera, të anketuarit më të rinj kanë qëndrime më pozitive ndaj homoseksualitetit⁴⁰, duke shpjeguar se ata socializohen në një kohë dhe në një kontekst që është i volitshëm për pranimin e homoseksualitetit, por ky nuk është rasti me hulumtimin tonë.

³⁹ Deklarata është pjesë e tekstit të vjetër shkollor për arsimin qytetar në arsimin e mesëm, që është jashtë përdorimit.


⁴⁰ Van den Akker, H., Van der Ploeg, R., & Scheepers, P. (2013). Disapproval of homosexuality: Comparative research on individual and national determinants of disapproval of homosexuality in 20 European countries. *International Journal of Public Opinion Research*, 25(1), 64–86. Citim i marrë nga publikimi i Koalicionit Margjini (2023). Opresionet e fshehura haptazi: qëndrimet, vlerat dhe praktikat e qytetarëve dhe qytetarëve në lidhje me pjesëmarrjen politike dhe homoseksualitetin.

Pasqyra 100: Homoseksualiteti është sjellje devijante (sipas moshës)



Sipas përkatësisë etnike, stereotipet më të shpeshta për homoseksualitetin janë pak më të përhapura te të rinjtë shqiptarë, megjithëse përqindja mbetet mjaft e lartë tek të rinjtë nga grupet e tjera etnike.

Pasqyra 101: Homoseksualiteti është sjellje devijante (sipas përkatësisë etnike)



Pothuajse gjysma e të rinjve pajtohen me mbifuqinë e shtetit dhe me çmimin e lirive të tyre

Lidhur me deklaratën “Qytetarët besnikë janë gjithmonë të gatshëm të ndjekin rregullat dhe rregulloret në shoqëri dhe me çmimin e heqjes dorë nga liritë e tyre”⁴¹, pothuajse gjysma e të rinjve (47,9%) pajtohen me një deklaratë të tillë. Një qëndrim i tillë mund të interpretohet si pranim i autoritetit dhe mbifuqisë së shtetit, edhe nëse kjo do të thotë kufizim i lirive të tyre individuale.

Lidhur me deklaratën “Shteti mund të përdorë fuqinë e tij për të mbrojtur interesat e vetëm një grupi” për 45,7% të të rinjve, përgjithësisht është e pranueshme që shteti të ndërhyjë në këtë drejtim.

Tradicionalizmi mbizotëron edhe te të rinjtë. Puthja e dorës së më të rriturve ose mbajtja e roleve tradicionale të gruas është deri diku e pranueshme


Sa i përket deklaratës “Puthja e dorës së më të rriturve është shprehje e respektit për autoritetin”⁴², rezultatet tregojnë se për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve (44,8%) ky zakon është një mënyrë e pranueshme për të treguar respekt, ndërsa të tjerët e shohin atë si të vjetëruar.

Gati një në katër të rinj, (24,2%), pajtohen me deklaratën “nëse një grua është e mbyllur në shtëpi dhe nuk ka ndonjë rol publik, ajo nuk ka mundësi të kryejë vepra penale”, e cila nënçmon dhe diskriminon rolin shoqëror të gruas. Pajtueshmëria më e shpeshtë me këtë deklaratë është midis të anketuarve shqiptarë (37,5%), pastaj midis të anketuarve maqedonas (20,4%) dhe grupeve të tjera etnike (18,1%).

41 U tërhoq teksti shkollor për edukimin qytetar të dedikuar për klasat e teta.

42 U tërhoq teksti shkollor për edukimin qytetar të dedikuar për klasat e teta.

Pasqyra 102: Nëse gruaja është e mbyllur në shtëpi dhe nuk ka ndonjë rol publik, ajo nuk ka mundësi të kryejë vepra penale (sipas përkatësisë etnike)



TOLERANCA DHE PERCEPTIMET PËR GRUPET TJERA

Kjo pjesë e anketës përfshinte pyetje që shqyrtonin se sa të hapur janë të rinjtë ndaj diversitetit dhe shumëllojshmërisë, respektivisht sa të prirur janë ata të kenë bindje ose paragjykime ndaj njerëzve që janë të ndryshëm nga ata.

Prirja ndaj paragjytimeve po rritet te të rinjtë


Përmes pyetjes së parë në këtë pjesë, të anketuarit patën mundësinë të deklarojnë nëse do të shqetësoheshin nëse fqinji ishte i një kombësie tjetër, përkatësisë seksuale, person nga një qytet tjetër, person me aftësi të kufizuara, personi nga një opsion tjetër politik ose një refugjati nga një shtet tjetër.

Për personat LGBT, të rinjtë kanë qëndrimin më të shprehur se do t'u pengonte t'i kishin ata fqinjë (43%). Refugjatët janë grupi tjetër që të rinjtë tregojnë se nuk janë të gatshëm të kenë si fqinjë – çdo i treti i ri do të kishte një problem me një fqinj refugjat (35,6%). Në lidhje me të gjitha karakteristikat e shqyrtuara, vërehet një numër i caktuar i të rinjve që refuzojnë të përgjigjen dhe të ndajnë pikëpamjet e tyre në lidhje me anëtarët e grupeve të tjera, dhe kjo përqindje është më e spikatur për refugjatët nga një vend tjetër.

Sa i përket pjesëtarëve të komuniteteve etnike që jetojnë në vendin tonë, më të spikatura janë paragjykimet ndaj pjesëtarëve të komuniteteve etnike rome (24,9%) dhe shqiptare (24,1%), të cilëve të rinjtë shprehin mosgatishmëri për t'i pasur si fqinjë. Ka pak më pak mungesë vullneti për të pasur një fqinj (turk/e) (18,6%) ose një serb/e (10,2%), dhe më pak një fqinj maqedonas/e (6%).

Vetëm rreth 7% e të rinjve kishin problem të kishin një fqinj me aftësi të kufizuara, person nga një qytet tjetër, person nga një opsion tjetër politik.

Pasqyra 103: A do t'ju pengonte nëse fqinji juaj është...



Ajo që është shqetësuese është se, krahasuar me hulumtimin e mëparshëm të vitit 2021, përqindja e të rinjve që kanë problem me të gjitha grupet e radhitura është në rritje serioze. Rritja më e madhe shihet në mosdurueshmërinë ndaj LGBT (20% rritje), por edhe në rritjen e mosdurueshmërisë ndaj pothuajse të gjitha grupeve etnike.

Pasqyra 104: A do ta kishit problem nëse fqinji juaj do të ishte... (analiza e trendit - përgjigjja "Do të më pengonte")⁴³

	2021 ("Do të më pengonte")	2023 ("Do të më pengonte")	Dallimi në % midis dy hulumtimeve
Maqedonas/e	0,5 %	6 %	+5,5 %
Shqiptar/e	14 %	24 %	+10 %
Rom/e	14 %	25 %	+11 %
Turk/e	8 %	19 %	+11 %
Serb/e	7 %	10 %	+3 %
Refugjat/e nga një shtet tjetër	27 %	36 %	+9 %
Person LGBT	23 %	43 %	+20 %
Parti tjetër politike nga imja	5 %	7 %	+2 %

⁴³ Dy përgjigje, në lidhje me personat me aftësi të kufizuara dhe personat nga një qytet tjetër, u plotësuan në hulumtimin në vitin 2023 dhe nuk ishin pjesë e hulumtimit të mëparshëm. Prandaj, ato mbeten jashtë analizës së trendit.

Të ndarë sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, rezultatet tregojnë se jo aq pak të rinj do ta kishin problem të kishin një fqinj nga një komunitet etnik që nuk është i njëjtë me të tyre. Për shembull, madje një të tretës (33%) të maqedonasve të rinj etnikë do t'u pengonte të kishin një fqinj shqiptar, 27% të kishin një fqinj rom, 19,2% një fqinj turk dhe vetëm 3,2% do të shqetësoheshin nga një fqinj serb.

Te shqiptarët etnikë, më së shumti do t'u pengonte të kishin një fqinj serb dhe më së paku një fqinj maqedonas. Më saktësisht, 32,2% e shqiptarëve nuk do të donin të kishin një fqinj serb (32,2%), 22,9% nuk do të donin një fqinj turk, 27,8% nuk do të donin një fqinj rom, 19,6% nuk do të donin një fqinj maqedonas.


Pasqyra 105: Përqindja e të anketuarve të cilëve do t'u pengonte një fqinj nga një komunitet tjetër etnik, (sipas përkatësisë etnike)

Te të anketuarit maqedonas	1. Pengon të qënit shqiptar (33%)	2. Pengon të qënit rom (27%)	3. Pengon të qënit turk (19,2%)	4. Pengon të qënit serb (3,2%)
Te të anketuarit shqiptarë	1. Pengon të qënit serb (32,2%)	2. Pengon të qënit rom (27,8%)	3. Pengon të qënit turk (22,9%)	4. Pengon të qënit maqedonas (19,6%)
Te të anketuarit turq	1. Pengon të qënit rom (10%)	2. Pengon të qënit maqedonas (10%)	3. Pengon të qënit serb (7,5%)	Pengon të qënit shqiptar (5%)
Te të anketuarit rom	1. Pengon të qënit shqiptar (14,3%)	Grupet tjera etnike (0%)	Grupet tjera etnike (0%)	Grupet tjera etnike (0%)
Te të anketuarit serb	1. Pengon të qënit shqiptar (33,3%)	2. Pengon të qënit rom (14,3%)	3. Pengon të qënit turk (9,5%)	4. Pengon të qënit maqedonas (0%)

Çdo i katërti i ri në shtet konsideron se i përkasin një grupi etnik që është më i mirë se të tjerët

Perceptimi i grupit etnik të cilit i përkasin, në raport me të tjerët, tregon se në shkallën më të madhe të rinjtë nuk e konsiderojnë grupin e tyre as më të mirë e as më të keq se të tjerët (59,9%). Kur të rinjtë flasin për grupin e tyre etnik, rreth një në katër të rinj (38,7%) theksojnë se është më mirë se të tjerët, dhe vetëm 1,4% mendojnë se është më keq se të tjerët.

Pasqyra 106: Perceptimet e grupeve etnike



Të ndarë sipas karakteristikave demografike, rezultatet tregojnë se përshtypja e superioritetit së grupit personal etnik ndaj të tjerëve është më e lartë te burrat, të rinjtë (15 deri në 18 vjeç), shqiptarët etnikë dhe të rinjtë që jetojnë në fshat.

Pasqyra 107: Perceptimet e grupeve etnike (sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike - përgjigje "Grupi/përkatësia im(e) etnike është më e mirë se të tjerët")

Gjinia		Moshë			
Burra	Gra	15-18	19-24	25-29	30-35
41,8 %	35,8 %	41,2 %	39,7 %	39,4 %	36,6 %

Përkatësia etnike			Vendbanimi	
Maqedonas	Shqiptar	Tjetër	Fshati	Qyteti
33,8 %	60,4 %	21,5 %	46 %	34,2 %


Të dhëna të tilla tregojnë se disa të rinj kanë vështirësi të shohin ose kuptojnë shoqërinë si një komunitet ku të gjitha grupet janë njësoj të rëndësishme.

Një e katërta e të rinjve maqedonas dhe shqiptarë nuk kanë një shok nga një grup etnik tjetër

Më në fund, të rinjtë u pyetën, “Sa miq të ngushtë keni që i përkasin një grupi etnik tjetër nga i juaji?” për të fituar këqyrje për shkallën e diversitetit të qarqeve shoqërore të të rinjve, ku një numër më i madh i miqve nga grupe të ndryshme etnike mund të tregojnë një rrjet më të gjerë shoqëror dhe hapjen ndaj diversitetit, ndërsa një numër më i vogël mund të zbulojë një drejtim në grupe të ngjashme etnike në kontaktet sociale.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se shumica e të rinjve kanë miq nga përkatësi të ndryshme etnike, por në të njëjtën kohë ka shenja të ndarjes sociale dhe distancës etnike, duke filluar nga fakti se një në katër të rinj nuk ka një mik nga një komunitet tjetër etnik.

Pasqyra 108: Sa miq të ngushtë keni që i përkasin një grupi etnik tjetër nga i juaji?




Sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, një numër pothuajse i barabartë i maqedonasve etnikë (26%) dhe shqiptarëve etnikë (24%) nuk kanë ndonjë shok që i përket një bashkësie etnike tjetër nga ajo e tyre, ndërsa e njëjta gjë është e vërtetë në një përqindje më të vogël për grupet e tjera etnike (9%).

Ajo që tregojnë rezultatet është se të rinjtë që nuk kanë miq tjerë të grupit tjetër etnik përveç të tyre kanë më shumë gjasa se të tjerët të kenë një problem me një fqinj që nuk është nga grupi i tyre etnik. Ky fenomen është më i theksuar në mesin e të anketuarve etnikë maqedonas. Në fakt, në mesin e maqedonasve etnikë që nuk kanë miq nga një grup etnik tjetër, pothuajse gjysma e tyre do të shqetësoheshin nëse fqinji i tyre do të ishte shqiptar

(44,7%) ose rom (46,6%). Midis shqiptarëve etnikë dhe atyre të anketuarve nga grupe të tjera etnike, kjo përqindje është shumë më e ulët.

Për më tepër, është mbresëlënëse që mendimi për superioritetin e grupit të vet etnik zvogëlohet me rritjen e numrit të miqve që i përkasin një grupi etnik të ndryshëm nga ai i veti. Me fjalë të tjera, sa më shumë miq nga grupe të ndryshme etnike, aq më pak deklarata për superioritetin e grupit të tyre etnik në raport me të tjerët.

Pasqyra 109: Mendimi për përkatësinë etnike të tyre kundrejt të tjerëve./Sa miq të ngushtë keni që i përkasin një grupi etnik tjetër nga i juaji?



SHKALLA E PAJTUESHMËRISË ME DEKLARATAT QË LIDHEN ME VEPRIMTARINË SOCIO-POLITIKE, VLERAT POLITIKE DHE MENDIMIN KRITIK

Ky segment i fundit i anketës në terren i ballafaqoi të rinjtë me një sërë deklaratash të nxituara nga jeta sociopolitike, mbi të cilat ata u pyetën të thoshin nëse pajtoheshin ose jo me ta. Disa nga deklaratat përsëriten me ato të përfshira në tre hulumtimet e mëparshme, dhe disa janë të reja.

Një rënie e lehtë e paragjytimeve të të rinjve në krahasim me para pesë vjet më parë, por në përgjithësi ende për një numër të madh të të rinjve është një lider i pranueshëm me një dorë të fortë, duke përjashtuar personat LGBT dhe gratë nga politika

Në kuadër të katër hulumtimeve të deritanishme (2019, 2020, 2021 dhe 2023), të rinjtë u përballën me një grup prej gjashtë deklaratash të ndryshme.


Nga deklaratat e ofruara, mbështetja më e madhe midis të rinjve ekziston për një lider me dorë të fortë. Përqindje e lartë prej 81,3% e të anketuarve pajtohen me deklaratën se vendi ynë ka nevojë për një lider të tillë (57% kanë pajtueshmëri të plotë dhe 23,8% deri diku), ndërsa vetëm 15,8% e të rinjve nuk pajtohen se një lider me dorë të fortë është i nevojshëm (9.3% deri diku nuk pajtohen dhe 6,5% nuk pajtohen fare).

Për deklaratën se “Të gjitha partitë janë njësoj”, pothuajse dy të treta e të rinjve (59,4%) shprehën pajtueshmëri, gjë që mund të pasqyrojë dëshprim ose mosbesim në dallimet midis partive. Në të kundërt, më shumë se një e treta e të rinjve nuk e ndajnë këtë qëndrim (37,9%). Është mbresëlënëse që 50% e të rinjve që nuk dalin në zgjedhje mendojnë se të gjitha partitë janë njësoj. Në të njëjtën kohë, në mesin e të rinjve që deklarojnë se votojnë gjithmonë, gati një e treta (30,5%), ekziston një qëndrim se të gjitha partitë janë të njëjta.

Qëndrimi se personat LGBT nuk e kanë vendin në politikë ndahet nga 53,9% e të rinjve. Ky është një qëndrim domethënës dhe dëshprues, pasi tregon se për më shumë se gjysmën e të rinjve, personat LGBT duhet të jenë jashtë procesit politik. Në të kundërt, 40,1% e të rinjve nuk e ndajnë


këtë qëndrim. Ajo që është më shqetësuese është se edhe të rinjtë që janë aktivë në shoqëri në përgjithësi tregojnë pikëpamje të ngjashme për këtë çështje me të rinjtë që nuk janë aktivë në shoqëri. Kjo tregon se qëndrimet në lidhje me të drejtat LGBT nuk janë të lidhura në mënyrë dramatike me nivelin e aktivitetit shoqëror, dhe gjithashtu tregon se ky lloj paragjykimi dhe qëndrimesh negative ndaj personave LGBT përhapen dhe janë të pranishme në qarqe të ndryshme sociale dhe shoqërore.

Pasqyra 110: Personat LGBT nuk i përkasin politikës (sipas anëtarësisë në organizata)



Paragjykimi se burrat janë politikanë më të mirë se gratë ndahet nga gati një e treta e të rinjve (29,1%), megjithëse shumica e të rinjve nuk pajtohen me këtë deklaratë (68,3%). Sa i përket dallimit të mendimit midis burrave dhe grave, shqetësuese është madje se 40,3% e të anketuarve meshkuj pajtohen me deklaratën se burrat janë politikanë më të mirë sesa gratë, gjë që tregon qartë se ata i shohin cilësitë e një lideri përmes prizmit të gjinisë së tyre, në vend të aftësive, shkathtësive dhe karakteristikave të tyre si lider. Por, edhe të anketuarat, një përqindje jo aq e vogël (18,3%), pajtohen se burrat janë politikanë më të mirë se gratë. Mendimi midis grave se ato janë politikane më të këqija se burrat mund të jetë rezultat i disa faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë bindjet kulturore dhe pritjet për rolin e grave në shoqëri, ndikimin e mediave, mungesën e shembujve pozitivë të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe disa të tjerë.

Pasqyra 111: Burrat janë politikanë më të mirë se gratë (sipas gjinisë)




Të anketuarit shprehin një shkallë të lartë të mospajtueshmërisë me deklaratën se është më e mençur që të rinjtë të mbajnë për vete mendimin e tyre për zhvillimet politike në vend që ta shprehin publikisht. Në fakt, 7 nga 10 të rinj (72,4%) nuk pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa rreth 25% e të rinjve, ose një në katër të rinj, ende do të mbante mendimin e tyre për zhvillimet politike për veten e tyre.

Rreth një në pesë të rinj (20,1%) pajtohen se politika është çështje e politikanëve në të cilën të rinjtë nuk duhet të përzihen. Pjesa tjetër prej rreth 78% nuk pajtohen dhe pikërisht në këtë deklaratë vihet re përqindja më e lartë e mospajtimeve.

Nëse bëjmë një krahasim me rezultatet e hulumtimit të parë të kryer pesë vjet më parë, në vitin 2019, mund të shohim se të gjashtë deklaratat kanë disa zhvendosje pozitive. Për shembull, megjithëse zhvendosjet nuk janë të mëdha, ende më pak të rinj të anketuar në vitin 2023 besojnë se personat LGBT nuk kanë vend në politikë, ose se burrat janë politikanë më të mirë se gratë në krahasim me vitin 2019.

Pasqyra 112: Pajtueshmëri me deklaratat (analiza e trendit)

Përgjigje të ndara - pajtohem deri diku dhe pajtohem plotësisht me deklaratën.




Përveç këtyre gjashtë deklaratave që përsëriten në të gjitha hulumtimet e mëparshme, lista u plotësua me tre deklarata të reja që lidhen me mendimin e të rinjve për demokracinë, përfshirjen në politikë dhe mënyrën e shprehjes së ndikimit politik.

Sa i përket sistemit politik, 73,8% e të rinjve pajtohen me deklaratën se pavarësisht gjithçkaje, demokracia është sistemi më i mirë politik. Kjo tregon një pranim të gjerë të demokracisë si forma e preferuar e qeverisjes. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve (rreth 1 në 5 të rinj) besojnë se mund të ketë forma alternative të qeverisjes që janë më të mira se demokracia.

Për sa i përket përfshirjes së të rinjve në politikë, ka një ndryshim në qëndrime. Rreth gjysma e të anketuarve (47,3%) besojnë se të rinjtë nuk duhet të përfshihen në politikë - ndoshta sepse nuk mendojnë se të gjithë kanë interes ose cilësi për të qenë pjesë e vendimeve politike - ndërsa pak më shumë se gjysma (50,9%) nuk pajtohen me një deklaratë të tillë.


Lidhur me mundësinë e ndikimit politik vetëm duke dalë në zgjedhje, dy të tretat e të rinjve (73,2%) nuk pajtohen se dalja në zgjedhje është e mjaftueshme për të ndikuar në politikë. Kjo tregon vetëdijen për nevojën e pjesëmarrjes aktive në proceset politike, jo vetëm përmes votimit në zgjedhje, por edhe përmes aktiviteteve dhe mekanizmave të tjerë për ndikim. Por pavarësisht kësaj vetëdije, siç tregojnë të dhënat nga ky hulumtim më parë, më pak se një e katërta e të rinjve tregojnë aktivitet social.

A photograph of a person with long hair tied back, wearing glasses and sitting in a wheelchair. They are looking at a laptop screen in what appears to be a classroom or office environment. The image is overlaid with a semi-transparent red filter. The text is centered in the lower half of the image.


PERCEPTIMET DHE
QËNDRIMET E TË
RINJVE ME AFTËSI
TË KUFIZUARA
SENZORIKE DHE/OSE
DHE/OSE MOTORIKE
PËR SITUATËN
NË VEND

Pasqyra e mëposhtme përmban përgjigjet e të anketuarve, të rinjve me aftësi të kufizuara sensorike dhe/ose motorike që ishin pjesë e mostrës shtesë përforcuese ("booster") dhe atyre që ishin pjesë e mostrës përfaqësuese nacionale (32 të anketuar gjithsej).


Grupi i mëposhtëm tregon përgjigjet e të anketuarve me aftësi të kufizuara sensorike dhe/ose motorike për temën e tendencave sociale në vend, pozicionin e tyre në shoqëri dhe anëtarësimin në BE.



Grupi i mëposhtëm tregon përgjigjet e të anketuarve me aftësi të kufizuara sensorike dhe/ose motorike në temën e informimit, migrimit, besimit në institucione dhe pjesëmarrjes qytetare.



Grupi i fundit tregon përgjigjet e të anketuarve me aftësi të kufizuara sensorike dhe/ose motorike ndaj temës së votimit në zgjedhje, qëndrimeve politike dhe frikës.



Në përgjithësi, krahasuar me të rinjtë e tjerë, këta të anketuar janë pak më pesimistë për drejtimin e shtetit, por në të njëjtën kohë pak më optimistë për mundësinë e ndryshimeve pozitive në të ardhmen. Përveç kësaj, këta të rinj në një përqindje më të madhe mendojnë se institucionet kujdesen për ta dhe nevojat e tyre, por janë dukshëm më pak të konsultuar nga institucionet kur marrin vendime. Të rinjtë aktivë në shoqëri në këtë grup janë pothuajse dy herë më të shumtë se popullsia e përgjithshme e të rinjve. Vërehet një gatishmëri më e ulët për t'u shpërngulur, por një gatishmëri më e madhe për të votuar.



GJETJET E PËRMBLEDHURA NGA GRUPET E FOKUSIT

Rrjedhat sociale në vend

Diskutimet⁴⁴ me të rinjtë zbuluan një ndjenjë të fortë zhgënjimi në lidhje me rrjedhat shoqërore në vend dhe mungesë shprese për mundësitë për përmirësimin e situatës në të ardhmen e afërt. Ndarjet e thella politike, mosfunksionimi i institucioneve dhe korrupsioni i përhapur gjërësisht janë identifikuar si pengesat kryesore për përparimin e shtetit. Të rinjtë e shohin shoqërinë si një sistem ku “asgjë nuk mund të bëhet pa para dhe miq/lidhje” dhe në të cilën korrupsioni është ngulitur në mentalitetin e qytetarëve si një mënyrë normale e funksionimit. Sistemi i drejtësisë shihet me cinizëm të veçantë dhe shpesh kritikohet për dështimin për t’i bërë elitat politike më të përgjegjshme për veprimet e tyre. Emigrimi i të rinjve dhe deficitin që krijon shihet si një tjetër pengesë e rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të vendit.

Sfidat kryesore me të cilat përballen të rinjtë

Në kuadër të diskutimeve, të rinjtë identifikuan një sërë sfidash me të cilat përballen, duke theksuar kryesisht standardet e ulëta të jetesës si një faktor që kërcënon jetesën e tyre dhe përforcon ndjenjën e mungesës së shpresës. Kjo ndjenjë e pavolitshmërisë përkeqësohet më tej nga mungesa e mundësive për punë, si dhe aktivitetet kulturore dhe sociale që mund të pasurojnë jetën e tyre, veçanërisht për ata të rinj që jetojnë jashtë kryeqytetit.

Mundësitë për mobilitet sociale dhe ndërprerjen e ciklit ndër gjenerata të varfërisë perceptohen si afatgjata dhe të vështira për t’u arritur.

Cilësia e arsimit është një tjetër sfidë e rëndësishme e theksuar nga të rinjtë. Pjesëmarrësit menduan se sistemi aktual nuk arrin të sigurojë aftësitë dhe cilësinë e nevojshme, duke i vendosur ata në pozitë të pavolitshme në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga vendet e BE-së. Shumica e të rinjve kishin dëshirë të studionin jashtë vendit, me theks në vendet e BE-së dhe SHBA-së.

Për më tepër, situata shëndetësore është përshkruar si e papërshtatshme, duke ngritur shqetësime për mirëqenien themelore.

44 Të realizuara nga ana e TIM Institutit.

Angazhimi social midis të rinjve

Ndjenja e pasivitetit mbizotëron në shumicën e të rinjve dhe rrallëherë ndonjë nga pjesëmarrësit raporton një formë të angazhimit shoqëror. Në përgjithësi, të rinjtë nuk kanë shprehur aspirata të veçanta për të drejtuar kapacitetet e tyre drejt zgjidhjes aktive të problemeve sociale. Rezistenca ndaj angazhimit shoqëror nxitet kryesisht nga një ndjenjë se gjërat janë të vështira për t'u ndryshuar, edhe kur të rinjtë tregojnë gatishmëri për t'u angazhuar në jetën publike. Frika nga kërcënimet e mundshme politike, etiketimet dhe presionet u veçuan si arsye shtesë për të "qëndruar anash". Për më tepër, të rinjtë vlerësuan se përpjekjet e institucioneve për përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes ishin më shpesh deklarative. Megjithatë, disa nga të rinjtë shprehën interes për t'u angazhuar në jetën sociopolitike përmes pjesëmarrjes në këshillat rinorë në kuadër të komunave.

Perceptimet për BE-në dhe NATO-n

Midis pjesëmarrësve në grupet e fokusit, dy perceptime jashtëzakonisht kontradiktore të BE-së janë të dukshme. Nga njëra anë, një pjesë e pjesëmarrësve e shohin BE si një "pakt me ujqërit", duke argumentuar se Bashkimi Evropian nuk ka synime të sinqerta të zgjerimit në të ardhmen e afërt. Këta të rinj besojnë se BE-ja nuk përfaqëson interesat më të mira të shtetit dhe se mesazhet që vijnë prej saj janë hipokrite. Nga ana tjetër, një pjesë tjetër e pjesëmarrësve flasin për anëtarësimin në BE si një mundësi që shteti të promovojë liritë e qytetarëve, standardet e jetesës, perspektivat sociale, sigurinë dhe ndjenjën e komunitetit.

Kërkesat që i shtrohen vendit tonë për anëtarësim në BE vlerësohen kryesisht si shumë të rënda, ndërsa përmbushja e tyre nuk është garanci për hyrjen e vendit në Bashkimin Evropian. Disa nga pjesëmarrësit e shohin vetë Bashkimin Evropian si pengesën kryesore për hyrjen e vendit në Bashkimin Evropian. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve besojnë se përgjegjësia për statusin tonë aktual qëndron në dështimin dhe mos motivimin e partive politike në pushtet për të realizuar reformat e nevojshme të brendshme.

Ekzistojnë gjithashtu shqetësime serioze se hyrja në Bashkim Evropian do të shkaktonte një largim shtesë të fuqisë punëtore të re dhe të aftë të vendit.

Për disa nga pjesëmarrësit, anëtarësimi në NATO nënkupton mbrojtjen e integritetit territorial dhe rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit. Megjithatë, shumica e pjesëmarrësve besojnë se vendi ynë nuk ka ndonjë përfitim të

veçantë nga anëtarësimi në NATO, por vetëm një dalje nga buxheti i vendit që mund të investohet në fusha ku është shumë më e nevojshme, siç janë arsimit dhe shëndetësia.

Kuptimet për demokracinë dhe liderit të dëshiruar

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në grupe të fokusit e lidhin demokracinë me: sundimin e popullit, lirinë e fjalës, sundimin e ligjit, barazinë dhe barazinë e qytetarëve. Vendet e mëposhtme u përmendën si shembuj të shteteve demokratike: Amerika, Danimarka, Norvegjia, Finlanda, Zvicra, Gjermania dhe Sllovenia. Për më tepër, ekziston një konsensus se në vendin tonë ekziston një "kuazi" rend demokratik për shkak të mungesës së sundimit të ligjit, llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve.

Sa i përket llojit të politikanëve në vend dhe llojit të liderëve që të rinjtë duan, ka një mospërputhje të dukshme. Politikanët aktualë u përshkruan si të korruptuar, egoistë, agresivë dhe jokompetent. Nga ana tjetër, të rinjtë duan lider që do të jenë përmbushës, transparentë, profesionistë dhe me përvojë.

Perceptimi i një lideri me dorë të fortë lëviz midis dy polariteteve – "politikanit ideal" dhe "diktatorit". Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve e shohin liderin me një dorë të fortë si një lider ideal në të cilin ata projektojnë të gjitha vlerat e humbura për politikanët në vendin tonë. Megjithatë, kur pjesëmarrësve iu kërkua të vinin në dukje një profil ideal të një lideri, më shpesh u ndanë politikanët me tendenca autoritare.

Në nivel lokal, ekziston një vetëdije relativisht e ulët për punën dhe kompetencat e kryetarëve të komunave dhe komunave. Zgjerimi i paplanifikuar i ndërtimit u veçua si kritika kryesore për kryetarët e komunave dhe komunave, në kurriz të reduktimit të sipërfaqeve publike. Mungesa e higjienës publike dhe ndotja e ajrit përmenden gjithashtu në diskutimet e të rinjve.

Lidhur me deputetët, të rinjtë theksuan se duhet të veprojnë më shumë si individë dhe më pak si përfaqësues të interesave partiake. Ekziston gjithashtu nevoja për të rritur kontaktin më të drejtëpërdrejtë të deputetëve me qytetarët nga zona zgjedhore në të cilën ata morën mandatin.

Gjithëpërfshirja dhe pranimi i diversitetit

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit vunë në dukje trendin e rënies së tolerancës dhe pranimi të kategorive të caktuara të qytetarëve (siç janë

personat LGBTI), si dhe një rritje të dhunës së bashkëmoshatarëve në shkolla. Në të njëjtën kohë, disa nga pjesëmarrësit besojnë se ka një ndjeshmëri dhe përfshirje disi më të madhe të personave me aftësi të kufizuara.

Izolimi social gjatë pandemisë të shkaktuar nga virusi KOVID-19, ekspozimi i tepërt ndaj përmbajtjes negative në internet, edukimi i pamjaftueshëm, mungesa e komunikimit me “të ndryshëm nga vetja” dhe ndikimet që vijnë nga shtëpia përmenden si disa nga arsyet që ndikojnë në intensifikimin e paragjykitimit dhe intolerancës ndaj grupeve të caktuara të qytetarëve.

The image features a solid red background with four light pink speech bubbles scattered across the upper and middle sections. Each bubble is a simple, rounded shape with a small tail pointing downwards, suggesting conversation or dialogue. The bubbles are arranged in a loose, non-linear pattern.

DISKUTIM DHE
PËRFUNDIME

Qëllimi i këtij hulumtimi që është i katërit mbi pjesëmarrjen sociopolitike të të rinjve në Maqedoninë e Veriut, i kryer nga Fondacioni për demokraci të Uestminster, ishte të ofronte një pasqyrë gjithëpërfshirëse të një sërë aspektesh që lidhen me pjesëmarrjen sociopolitike të të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Studimi ofroi këqyrje në qëndrimet e të rinjve për disa tema kryesore: zhvillimet socio-politike në vend dhe pozicionin e të rinjve në shoqëri; pikëpamjet e të rinjve për të ardhmen e vendit dhe perspektivën për në BE; besimin e të rinjve në punën e institucioneve, si dhe mundësinë që të rinjtë të ndikojnë personalisht dhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse institucionale; niveli i përfshirjes socio-politike midis të rinjve, përmes pjesëmarrjes në forma të ndryshme të bashkimit dhe votimit në zgjedhje; dhe vlerat politike midis të rinjve. Përmes analizës së secilit prej këtyre segmenteve, hulumtimi gjithashtu ofroi njohuri për implikimet më të gjera që ato sjellin.

Rritet pesimizmi te të rinjtë

Gjetjet e studimit paralajmërojnë se të rinjtë në Maqedoninë e Veriut mbeten të sfiduar nga faktorë të ndryshëm në fusha të ndryshme të jetës së tyre. Në përgjithësi, analiza e trendit (e mundësuar nga analiza krahasuese e rezultateve me tre hulumtimet e mëparshme) tregon qartë se të rinjtë shprehin pakënaqësi në rritje për drejtimin në të cilin po lëviz shteti, trajtimin nga institucionet dhe pozicionin e tyre në shoqëri. Lidhur me këto çështje, ekziston pa mëdyshje një "rënie e lirë" në kënaqësinë e të rinjve për sa i përket mjedisit sociopolitik dhe një shkelje e mëtejshme e besimit në sistemin politik dhe në institucione.

Pritshmëritë e ardhshme të të rinjve në Maqedoninë e Veriut gjithashtu mbeten në një nivel mjaft të ulët. Shumica e të rinjve nuk shohin mundësinë e ndonjë ndryshimi thelbësor në pesë vitet e ardhshme. Megjithatë shumë të rinj mbeten të rezervuar në lidhje me gjasat e ndonjë ndryshimi pozitiv afatshkurtër, megjithatë, disa të rinj lënë hapësirë për faktin se e ardhmja mund të çojë në një përmirësim të situatës.

Pesimizmi rrit edhe apatinë

Situata e përgjithshme e të rinjve në Maqedoninë e Veriut mund të përshkruhet si sfiduese dhe e pasigurt. Të rinjtë gjithnjë e më shumë humbasin interesin për angazhimin shoqëror, dhe në planin afatgjatë, kjo mund të çojë në marginalizimin e tyre të mëtejshëm dhe mungesën e përfaqësimit dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. Apatia e të rinjve, mbi të gjitha, nxitet

nga pakënaqësia e të rinjve me situatën në vend dhe pamundësia për të ndikuar në zgjidhjen e problemeve. Për më tepër, të rinjtë nuk mendojnë se pikëpamjet e tyre dëgjohen ose kuptohen dhe kanë besim të ulët në punën e institucioneve. Nga të gjitha institucionet e rradhitura, të rinjtë u besojnë më së paku aktorëve kryesorë politikë: partive politike, Qeverisë dhe Kuvendit. Kur bashkohen të gjitha sfidat me të cilat përballen të rinjtë, ekziston një ndjenjë e mungesës së shpresës që më së shpeshti manifestohet nga përqindja e madhe e të rinjve që deklarojnë se duan të largohen nga shteti.

Numri i të rinjve që do të emigronin mbetet i njëjtë, por numri i atyre që potencialisht do të ktheheshin po zvogëlohet

Aspiratat e migracionit janë ende një fenomen i përhapur gjërësisht në vitin 2023 në Maqedoninë e Veriut, me gati dy të tretat e të rinjve, si në hulumtimet e mëparshme, mbesin duke menduar për migrimin. Gjetjet zbulojnë më tej se në rast se migrojnë, gjithnjë e më pak të rinj do të konsideronin kthimin në shtet, krahasuar me hulumtimet e mëparshme. Prandaj, një nga ndryshimet kryesore që spikat në këtë hulumtim në lidhje me hulumtimet e kaluara nuk është numri i të rinjve që do të emigronin (i cili mbetet relativisht konstant), por në numrin e atyre që, pas shpërnguljes, do të vendosnin të ktheheshin në vend. Kjo tregon se një numër në rritje i të rinjve po mendojnë të blejnë një “biletë në një drejtim”, e cila mund të ketë pasojë të gjera në kapitalin njerëzor në dispozicion të shtetit. Nga faktorët që potencialisht do t'i mbanin të rinjtë në shtet, kryesisht, ata janë të lidhur me domenin privat (lidhjet familjare dhe miqtë), por jo edhe me punën e institucioneve.

Integrimi në BE si mundësia e fundit për shpëtim?

Besimi në anëtarësimin në BE është një nga faktorët e paktë pozitivë që ende i shpërqendron të rinjtë nga emigracioni, në krahasim me faktorët e lartpërmendur që inkurajojnë emigracionin. Konkretisht, përgjigjet e të anketuarve në lidhje me synimin për shpërngulje nga shteti lidhen me besimin në anëtarësimin e mundshëm në BE. Në fakt, ata të anketuar që mendojnë se vendi ynë do të bëhet anëtar i BE-së, do të shpërnguleshin në një masë më të vogël nga vendi në krahasim me ata që mendojnë se shteti ynë nuk do të bëhet anëtar i BE-së. Megjithatë, krahasuar me hulumtimet e mëparshme, dhe veçanërisht me hulumtimin e parë të vitit 2019, është e dukshme se integrimi në BE si faktor i mbajtjes së të rinjve në vend po humbet momentin

e tij. Në fakt, ka një rënie të numrit të të rinjve që besojnë se vendi një ditë do të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian dhe si rezultat do të qëndrojnë në shtet.

Për më tepër, gjetjet tregojnë një rritje në kohën mesatare që do t'i duhet vendit për t'u bërë anëtar i BE-së. Është interesante se në kuadër të hulumtimit të parë të kryer në vitin 2019, shumica e të rinjve prisnin që vendi të bëhej një shtet anëtar i BE-së në një periudhe prej pesë vjetësh (respektivisht deri në vitin 2024). Nga aspekti i sotëm, pritshmëritë e tilla të të rinjve kanë rezultuar se janë jorealiste të larta. Në kuadër të hulumtimit të fundit, pritshmëritë e të rinjve janë zvogëluar ndjeshëm, me shumicën e të rinjve (nga ata që besojnë se vendi do të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian) që shikojnë vitin 2032 si një vit mesatarisht të mundshëm për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Të rinjve nuk u intereson politika, megjithatë ata votojnë

Te të rinjtë dominon edhe mungesa e interesit për politikën dhe informimin politik. Dhe kur të rinjtë informohen, shpesh ndodh që ata të informohen nga burime të ndryshme në krahasim me ata që u besojnë më shumë. Është e habitshme që informimi politik i të rinjve zhvillohet kryesisht në një rreth të mbyllur, më së shpeshti në kuadër të familjes, gjë që mund të çojë në përjetësimin e qëndrimeve të mbajtura nga prindërit e tyre dhe të dashurit e tjerë.

Si paradoks në vete, përkundër faktit se të rinjtë nuk tregojnë interes të veçantë për politikën, megjithatë një pjesë e madhe e tyre vazhdimisht deklarojnë se dalin të votojnë. Prandaj, votimi në zgjedhje mbetet një nga format e rrala përmes të cilave të rinjtë ende vërtetojnë angazhimin e tyre politik. Arsyet e supozuara për këtë fenomen janë të shumta. Një shpjegim i mundshëm është se është mungesa e formave alternative të pjesëmarrjes sociopolitike dhe mundësia për të shprehur pozicionin e tyre në mënyra të tjera që inkurajon të rinjtë të përdorin votimin në zgjedhje si një mundësi e rrallë për të vepruar. Ajo që është inkurajuese është se shumica e të rinjve nuk besojnë se vetëm shkuarja në votime është e mjaftueshme për të ndryshuar gjërat.

Në të njëjtën kohë, niveli i të rinjve aktivë në shoqëri është i ulët. Një numër i madh i të rinjve nuk përshkruhen si aktivë në shoqëri dhe as nuk janë pjesë e ndonjë organizate të shoqërisë civile. Prandaj, besimi i të rinjve në shoqërinë civile/organizatat rinore është në një nivel mjaft të ulët (pothuajse gjysma e të rinjve nuk u besojnë atyre, dhe më pak se 5% janë anëtarë në to), gjë që tregon se një kanal i tillë i veprimit nuk është veçanërisht tërheqës për


të rinjtë. Partitë politike janë forma më tërheqëse e angazhimit sociopolitik për të rinjtë, madje edhe dy herë më shumë se organizatat e shoqërisë civile.

Ritradicionalizimi i të rinjve

Përmes një sërë pyetjesh të mbuluara nga hulumtimi, vihet re një prirje e ritradicionalizimit të të rinjve, duke filluar nga fakti se institucionet fetare gëzojnë besim më të lartë dhe më të qëndrueshëm në krahasim me shumicën e institucioneve dhe organizatave në vend, përmes qëndrimit që një numër në rritje i të rinjve shprehin qëndrim homofobik, ose pozicionojnë gratë në role tradicionale që lidhen me shtëpinë, si dhe qëndrimin ndaj njerëzve që i përkasin një grupi të ndryshëm etnik.

Konkretisht, duke iu referuar temës së marrëdhënieve ndëretnike, është shqetësues fakti që në disa raste, madje deri në një të tretën e të rinjve nuk duan të kenë një fqinj që është anëtar i një grupi etnik të ndryshëm nga i tyre. Më shpesh, ata të rinj që kanë një rreth miqsh nga grupet tjera etnike kanë pikëpamje më të mira për njëri-tjetrin. Ekziston gjithashtu intolerancë e lartë ndaj grupeve më të rrezikuara, siç janë refugjatët.

Të dhëna të tilla tregojnë se disa të rinj kanë vështirësi të shohin ose kuptojnë shoqërinë si një komunitet i të barabartëve. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se perceptime të tilla nuk janë universale, respektivisht të pranishme te të gjithë të rinjtë. Në të njëjtën kohë, në hulumtimin e vitit 2023, pati një rritje të qëndrimeve joliberales midis kategorive më të reja të të rinjve (të rinjtë nga 18 deri në 25 vjeç), dhe ky nuk ishte rasti me hulumtimet e mëparshme ku ishin kryesisht të rinjtë nga 30 deri në 35 vjeç që shprehën këtë lloj të qëndrimeve, gjë që sugjeron se ritradicionalizimi përfshin të gjitha kategoritë e moshës.



**DEMOCRACY
WORKS**

Westminster Foundation for Democracy

REKOMANDIME

Në kuadër të tre hulumtimeve të mëparshme në vitet 2019, 2020 dhe 2021, u rradhiten një sërë rekomandimesh vijuese. Për disa prej tyre, në periudhën nga hulumtimi i parë i realizuar pesë vjet më parë e deri më sot, është bërë një hap përpara në më shumë fusha:

- Shumica e komunave (dy të tretat e të gjitha komunave) kanë formuar këshillat lokal rinor, krahasuar me vetëm 12 komuna (nga gjithsej 80) në vitin 2021.
- Për një periudhë pesëvjeçare, janë hapur qendrat rinore në pesë komuna, duke e çuar numrin e përgjithshëm të qendrave rinore aktualisht në tetë, por mbulimi mbetet i vogël (10% e të gjitha komunave).
- Në nivel nacional, është miratuar një Strategji e re për të rinj 2023-2027, e cila, ashtu si këshillat lokale rinore dhe qendrat rinore, rrjedh si detyrim nga Ligji për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore.
- Në kuadër të institucioneve në nivel shtetëror dhe lokal, janë caktuar nëpunës për të rinj, si persona përgjegjës për koordinimin, realizimin dhe ndjekjen e çështjeve me interes për të rinjtë.
- Nga Agjencia për rini dhe sport, është krijuar një Regjistër i organizatave rinore që përditësohet rregullisht dhe është në dispozicion të publikut.
- Agjencia për rini dhe sport ndan mjetet financiare të dedikuara për të mbështetur projekte në fushën e të rinjve si pjesë e programit të saj vjetor.⁴⁵
- Janë formuar kuvendet studentore të universiteteve dhe fakulteteve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për arsimin e lartë.

Në të njëjtën kohë, pavarësisht këtyre lëvizjeve inkurajuese në politikat rinore, sfidat me të cilat përballen të rinjtë mbeten të shumta, dhe shumica e rekomandimeve të shënuara në tre hulumtimet e mëparshme janë ende të rëndësishme në kontekstin e gjetjeve të vitit 2023.

Disa nga rekomandimet e mëposhtme në këtë dokument janë rezultat i një procesi të konsultimeve me organizatat rinore dhe forumet rinore të partive politike në kuadër të ngjarjes “Udhërrëfyeni për të rinjtë” të mbajtur më 1 mars të vitit 2024, në të cilën ata patën mundësinë të paraqesin rekomandimet e tyre në më shumë fusha duke përfshirë standardin rinor, arsimin, mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrjen e të rinjve.

45 Mjetet buxhetore të ndara për këtë dedikim në vitin 2023 arritën në 5.600.000 denarë.

Politikat për të rinj dhe pjesëmarrjen rinore

- Zbatimi i plotë i Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore, veçanërisht në fushën e krijimit të Kuvendit për të rinj dhe Trupit nacional këshilldhënës, formimit të Qendrave rinore në komuna si dhe Qendrës hulumtuese të parashikuar në kuadër të Agjencisë për rini dhe sport.
- Plotësimet dhe ndryshimet në Ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore në konsultim me të rinjtë, veçanërisht në fushën e rregullimit më të saktë të ndarjeve financiare që rrjedhin nga ligji.
- Zbatimi i vazhdueshëm i Strategjisë nacionale për të rinj (2023-2027) të miratuar rishtazi dhe raportimi në kohë (të paktën një herë në vit) nga Qeveria dhe Agjencia për rini dhe sport në lidhje me shkallën e realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin e parë të veprimit 2023-2025, duke dhënë njohuri për përparimin në lidhje me indikatorët për matjen e suksesit të strategjisë. Klubi për çëshjtet dhe politikat rinore në Kuvend duhet të organizojë diskutime vjetore mbi zbatimin e strategjisë.
- Kuvendi të mendojë për formimin e Komisionit për të rinj.
- Formimi i këshillave lokal rinor në të gjitha komunat e mbetura në të cilat kjo nuk është bërë deri më tani (rreth një e treta e komunave). Këshillat lokal rinor duhet të marrin mbështetjen e duhur teknike, financiare dhe administrative për punën e tyre.
- Hapja e qendrave për të rinj në çdo komunë, të cilat do të përfaqësojnë një hapësirë për organizatat lokale rinore, organet e shkollave të mesme/studentëve, klubet, grupet joformale dhe iniciativat rinore për zhvillimin dhe realizimin e punës së tyre. Qendrat duhet të jenë të qasshme për të rinjtë me aftësi të kufizuara.
- Rritja e mjeteve buxhetore të Agjencisë për rini dhe sport, në veçanti të sektorit “të rinjtë”, në mënyrë që të arrihet një shpërndarje më e barabartë e financimit midis sektorëve “sport” dhe “të rinj”. Një pjesë e këtyre mjeteve duhet të dedikohen edhe për ekipimin kadrovik të sektorit “të rinj”.
- Sigurimi i mbështetjes më të madhe financiare për organizatat rinore nga buxheti i shtetit me qëllim rritjen e kapaciteteve, inovacionit, ofertës dhe dukshmërisë të tyre.

- Profesionalizimi i pozitës “Nëpunës për të rinj” dhe përforcimi i kapaciteteve të personave që punojnë në këtë pozitë.
- Miratimi i propozimligjit për arsimin e mesëm, i cili përcakton dhe garanton pjesëmarrjen e nxënësve dhe mundësitë për organizimin e nxënësve, si dhe njeh dhunën ndërmjet bashkëmoshatarëve dhe parasheh programe për mbrojtjen nga dhuna në shkolla.
- Përmirësimi i strategjive të komunikimit të institucioneve shtetërore dhe lokale me qëllim promovimin e mundësive për të rinj, përfshirjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe përforcimin e bashkëpunimit me të rinjtë.
- Përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse që tradicionalisht nuk janë “rinore”, siç janë politikat në fushën e mbrojtjes sociale, politikat shëndetësore, politikat në fushën e bujqësisë e të tjera.
- Partitë politike duhet të adresojnë çështjet e të rinjve përmes politikave të përshtatshme rinore në programet e tyre, të cilat duhet të krijohen në konsultim me forumet rinore dhe të rinjtë.
- Forumet rinore të partive politike duhet të sigurojnë hapësirë për ndërtimin e njohurive politike, dialogun, pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve në partitë politike dhe shoqërinë. Kjo duhet të bëhet duke u mundësuar të rinjve të krijojnë dhe zbatojnë programet e tyre, duke organizuar aktivitete me të rinjtë, duke mbajtur konsultime, duke kryer hulumtime dhe duke zhvilluar politika. Për më tepër, partitë politike duhet të sigurojnë mjete të mjaftueshme për forumet rinore të tyre, duke u siguruar atyre resurse të mjaftueshme për punë dhe për të përforcuar autonominë e tyre.

Standardet rinore dhe mundësitë e barabarta

- Vazhdimi i politikës "Garancia rinore" dhe popullarizimi i saj si një masë për përmirësimin e standardit rinor dhe punësimit.
- Krijimi i masave të reja që do të synojnë zvogëlimin e varfërisë midis të rinjve, veçanërisht grupeve të cënueshme të të rinjve (të tilla si të rinjtë romë, të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë që jetojnë në zonat rurale).
- Ngritja e çështjes së standardit rinor përmes miratimit të Ligjit për standardin rinor.
- Pëforcimi i sektorit privat duke përmirësuar legjislacionin dhe masat e punësimit të të rinjve, duke përfshirë lehtësimet tatimore, stimujt për punësimin dhe trajnimin e të rinjve, subvencionet e rrogave dhe masa të ngjashme.
- Avancimi dhe ndryshimet e Ligjit për përdorimin e gjuhës së shenjave me qëllim të adresimit më të mirë të nevojave të personave të shurdhër, si dhe sigurimi i programeve për të rinjtë me aftësi të kufizuara nga Agjencia për rini dhe sport dhe financimet përkatëse për të njëjtit.

Migracioni dhe bashkëpunimi

- Prezantimi i politikave për lehtësimin e mundësive të të rinjve për banim të pavarur, siç është mbështetja financiare në blerjen e banesave për të rinj.
- Masa të synuara për të avancuar dhe zbatuar migracionin qarkullues.
- Masat për avancimin e bashkëpunimit me të rinjtë që janë shtetas të Maqedonisë së Veriut, por që jetojnë jashtë vendit, përmes krijimit të rrjeteve të diasporës, programeve të mentorimit për transferimin e njohurive, financimin e projekteve hulumtuese dhe përfitimet për hapjen e një biznesi në vend.
- Përshpejtimi i negociatave me BE-në dhe përmbushja e kritereve të anëtarësimit, duke pasur parasysh se anëtarësimi në BE po dëshmon të jetë një nga aspektet kryesore që zvogëlon dëshirën për migrim midis të rinjve.

Edukimi dhe gjithëpërfshirja

- Ministria e arsimit dhe shkencës duhet të marrë në konsideratë përfitimet e rishikimit dhe reformimit të disa aspekteve kryesore të programeve mësimore dhe ofrimit të tyre, duke përfshirë zhvillimin e një strategjie se si të pajisen më mirë të rinjtë me aftësitë e nevojshme për shekullin 21 (edukimi dixhital, zgjidhja e problemeve, bashkëpunimi, mendimi kritik, arsimit politik dhe të tjera).
- Shkollat të organizojnë dhe nxisin aktivitete që i prezantojnë të rinjtë me institucionet, punën dhe rolin e tyre në punën për qytetarët, përmes vizitave studimore, ligjerata të ftuarve dhe aktiviteteve të tjera me vetëqeverisjet lokale dhe institucionet nacionale.
- Përmes një përpjekjeje të përbashkët të komunave, shkollave dhe aktorëve të tjerë përkatës për të zhvilluar më shumë mundësi për aktivitete të përbashkëta midis të rinjve të përkatësive të ndryshme etnike, si një masë për të adresuar mosdurimin dhe paragjykimet që ekzistojnë. Klasat e përbashkëta gjatë mësimdhënies, shkollat verore, punëtoritë dhe aktivitetet sportive janë pjesë e masave të mundshme për të tejkaluar paragjykimet.
- Mbështetja dhe promovimi i arsimit joformal në kuadër të institucioneve arsimore, duke nxitur bashkëpunimin me organizatat rinore dhe të shoqërisë civile, si dhe sektorin privat.
- Përforcimi i edukimit mediatik në kuadër të programore mësimore, veçanërisht aspektet që lidhen me informimin socio-politik dhe njohjen e dezinformatave, sensacionalizmit dhe teorive të konspiracionit.
- Zbatimi i pedagogjisë me ndjeshmëri gjinore si një mënyrë për të avancuar barazinë gjinore dhe për të zvogëluar paragjykimet dhe stereotipet gjinore.
- Financimi buxhetor i arsimit, sipas rekomandimeve të UNESCO-s, duhet të jetë në kuadër të 4-6% të PBB-së së rekomanduar dhe/ose të paktën 15-20% të shpenzimeve publike duhet të ndahen për arsimin.

BIBLIOGRAFIA

- Bojoviq-Stojkoska, S., Trojačanec, M. dhe Shabani, D. (2023). Aspiratat rinore për karrierë dhe aftësi.
- Galevski, M. (2019). Pjesëmarrja sociopolitike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut: Apatia, optimizmi ose dëshprimi (Studimi 2019). Shkup: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit.
- Gjorgjiovaska, J. dhe Galevski, M. (2020). Pjesëmarrja sociopolitike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut: Pabarazia, pasiguria dhe pritjet e ndryshme (Studimi 2020). Shkup: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit.
- Galevski, M., Ivanoviq, I. dhe Qetkoviq-Janeva, Jelena (2022). Pjesëmarrja sociopolitike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut: Fluturimi në vend (Studimi 2021). Shkup: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit.
- Enti shtetëror i statistikës. (2023). Projektionet e popullsisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2070. Shkup: Enti shtetëror i statistikës.
- Kulakov, F. (2023). Raporti i monitorimit të viti 2023 për zbatimin e Ligjit për pjesëmarrjen rinore dhe politikatat rinore. Shkup: Këshilli rinor nacional i Maqedonisë.
- Malevski, B. dhe Barakovski, P. (2023). Të rinjtë në regjistrim të popullsisë: Analiza e të dhënave të regjistrimit të popullsisë, ekonomitë familjare dhe banesat nga viti 2021 që kanë të bëjnë me të rinjtë. Shkup: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit.
- Naceva, B., Shimbov, B. dhe Galevski, M. (2023). Financimi i së ardhmes sonë: si të përmirësojmë efikasitetin e shpenzimeve për arsimin në Maqedoninë e Veriut. Shkup: Banka Botërore.
- Radio MOF (20 tetor 2023). Maqedonia e Veriut ndër më të këqijat në rajon sipas Indeksit të ri të zhvillimit rinor.
- Radio MOF (20 nëntor 2023). Më pak para për të rinjtë, shkencën dhe ekologjinë – Çfarë parashikon propozimbuxheti për vitin 2024
- Trajanovska, Lj. (2023). Analiza e (pa) barazive gjinore përmes prizmës të të rinjve në Maqedoninë e Veriut. Shkup: Këshilli rinor nacional i Maqedonisë dhe Shoqata për mundësi të barabarta "Rrjeti Stella".
- Shapkova-Kocevska, K. (2023). Financimi i politikave rinore. Analiza e mjeteve të ndara për Ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikatat rinore në vitin 2022. Shkup: Fondacioni për demokraci të Uestminsterit.
- Mojoska-Blazeski, N. (2024, in press³). North Macedonia Education Sector Analysis. Chapter 4: Relevance of Education for Labour Market Inclusion. Paris: UNESCO IIEP.
- UNICEF (2022). Are schools fit for purpose. The extent to which North Macedonia is getting the most out of the country's education resources. Shkup: UNICEF.
- Vergas, G. (2024, në shtyp 3). North Macedonia Education Sector Analysis. Chapter 2: Schooling patterns. Paris: UNESCO IIEP.
- UN Women (2023). Voices of Youth: Gender Equality and Social Cohesion in the Western Balkans. Serbia: UN Women.
- World Bank (2023). Economic Cost of Exclusion Based on Sexual Orientation, Gender Identity and Expression, and Sex Characteristics in the Labor Market in the Republic of North Macedonia.

